

PËRMBLEDHJE E DOKUMENTEVE PËR POLITIKA PUBLIKE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**SUPPORT TO
ELECTORAL REFORMS**

ПОДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
MBËSHTETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**SUPPORT TO
ELECTORAL REFORMS**
ПОДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
MBËSHITETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE



SUPPORT TO ELECTORAL REFORMS

ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
MBËSHTETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE

Ky publikim është prodhuar në suaza të projektit "Mbështetje për reformat zgjedhore" të finasuar nga Qeveria e Zvicrës dhe zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES). Qëndrimet dhe përmbajtja e shprehur në këtë publikim, nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit apo realizuesit.

Parathënie	4
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Aerodromit	7
▪ Vendparkime të pamjaftueshme në Komunën e Aerodromit - Valentin Manasievski (VMRO-DPMNE)	8
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Berovës	12
▪ Transporti rajonal dhe lokal në Berovë - Angella Zdravkovska (VMRO-DPMNE)	13
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Manastirit	17
▪ Manastiri me qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale - Mario Janevski (E Majta)	18
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Bërvenicës	22
▪ Këshilli rinor lokal në Komunën e Bërvenicës - Adem Jashari (Alternativa)	23
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Butelit	27
▪ Problemet ekologjike të lumit Serovë në Komunën e Butelit - Boris Petrovski (RDM)	28
▪ Problemi me qentë e pastrehë në komunën e Butelit - Xhuneit Rushid (Lëvizja për bashkin kombëtar te Turqve)	32
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Gazi Babës	36
▪ Betonimi i kanalit si zgjidhje prioritare nga ana e autoriteteve lokale - Abdulselam Kamberi (BDI)	37
▪ Qentë e pastrehë në Komunën e Gazi Babës - Viktorija Smilkovska (PLD)	41

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Gostivarit	45
▪ Mungesa e vendeve të parkimit në Komunën e Gostivarit - Admir Miftari (BDI)	46
▪ Vendosja e e-shërbimeve në Komunën e Gostivarit – Angella Avramovska (LSDM)	50
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Dolnenit	54
▪ Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën e Dollnenit - Deniz Miftari (BDI)	55
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kisela Vodës	59
▪ Vendosja e fitnes zonave në Komunën e Kisella Vodës - Gorjan Çurlinov (Partia e Vlllehëve ne Maqedoni)	60
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kriva Palankës	64
▪ Mungesa e vendparkimeve të mjaftueshme në Kriva Pallankë - Lina Rangellova (VMRO-DPMNE)	65
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kumanovës	69
▪ Shfrytëzimi i bibliotekës në Komunën e Kumanovës - Vjollca Murtezi (Alternativa)	70
▪ Infrastrukturë rrugore e papërshtatshme për personat e verbër në Komunën e Kumanovës - Julia Dimitrievska (E Majta)	74
▪ Transportuesit e paligjshëm në Komunën e Kumanovës - Millosh Ilievski (Për Kumanovën Tonë)	78
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Likovës	82
▪ Deponitë e egra në Komunën e Likovës - Herolinda Ramadani (Aleanca për Shqiptarët)	83
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Makedonski Brodit	87
▪ Vendosja e E-shërbimeve në Makedonski Brod - Sonja Jovanovska (PLD)	88

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Prilepit	92
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbrojtja nga dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Komunën e Prilepi - Natali Kitanovska (LSDM) 93 ▪ Komuna e Prilepit me Qendër Rinore - Hristijan Tuneski (VMRO-DPMNE) 97 	
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Radovishit	101
<ul style="list-style-type: none"> ▪ E-shërbimet në Komunën e Radovishit - Maja Uzhevaska (LSDM) 102 ▪ Si të ringjallet kultura e kinemasë në Radovish!? - Marija Kërsteva (LSDM) 106 	
Angazhimet e komunitetit në Qytetin e Shkupit	110
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesa e vendparkimeve në Qytetin e Shkupit - Marija Milloshevska (VMRO-DPMNE) 111 	
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Strumicës	115
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rivendosja e linjave të transportit publik në Strumicë - Andon Stojkov (LSDM) 116 	
Angazhimet e komunitetit në Komunën e Çairit	120
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesa e parkingjeve në Komunën e Çairit - Esra Demiri (BDI) 121 	

Parathënie

Kjo përmbledhje e dokumenteve të shkurtra për politika publike është pjesë përbërse e projektit "Mbështetje për reformat zgjedhore" të financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe realizuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES¹). Qëllimi kryesor i projektit është të promovojë procese zgjedhore demokratike dhe të besueshme që lehtësojnë pjesëmarrjen politike dhe integrimin social, duke u mundësuar votuesve të zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe t'i mbajnë ata llogaridhënës². Aktivitetet e projektit janë kanalizuar për të mbështetur objektivin e përgjithshëm duke arritur tre rezultate:

- ✓ **Rezultati 1: Institucionet e përforcuara zhvillojnë procese zgjedhore të drejta dhe efikase.**
- ✓ **Rezultati 2: Partitë politike të demokratizuara në brendësi që përfaqësojnë politikën dhe programet zgjedhore të orientuara drejt qytetarëve.**
- ✓ **Rezultati 3: Qytetarët e përforcuar thirrin partitë politike dhe zyrtarët e zgjedhur në llogaridhënie.**

Ndër të tjera, projekti mbështet partitë politike në zhvillimin e resurseve dhe kapaciteteve për të miratuar programe të bazuara në dëshmi me qëllim të përfshirjes më të madhe të komuniteteve lokale, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe grupet e tjera të cënueshme. Qasja e krijimit të politikave të bazuar në dëshmi kërkon të afrojë pikëpamjet e qytetarëve dhe krijuesve të politikave dhe të pasqyrojë nevojat reale në procesin e planifikimit të palëve duke ofruar analiza të thella dhe situata faktike përkatëse. Në arenën politike, krijimi i politikave i bazuar në dëshmi përfaqëson një përpjekje për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e politikave dhe programeve të propozuara.

Duke marrë parasysh këtë që është thënë më sipër dhe faktin se pjesëmarrja efektive e të rinjve në jetën politike dhe publike është thelbësore për zhvillimin demokratik, u organizua një Akademi për politikën publike në kuadër të projektit. Gjatë vitit 2022-2023, Akademia u drejtua nga Forumi për politika të arsyeshme (<https://frp.mk/>) dhe morën pjesë 29 pjesëmarrës nga 12 parti politike dhe një iniciativë qytetare. Aktivitetet për gjeneratën e tretë të pjesëmarrësve u zhvilluan

¹ <https://www.ifes.org/>

² Për më shumë informacione në lidhje me projektin, vizitoni ueb faqen zyrtare të projektit: <https://electoralreforms.mk/en/>

nga shtatori i vitit 2022 deri në qershor të vitit 2023. Akademia ka për qëllim që përfaqësuesit e të rinjve të partive politike në Maqedoninë e Veriut të edukojnë dhe rrisin udhëheqësit e ardhshëm politik dhe social të pajisur me vlera të përgjithshme dhe specifike dhe njohuri për proceset politike në vend. Si pjesë e programit të Akademisë, pjesëmarrësit zhvilluan 25 dokumente të shkurtra të politikave publike, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij botimi.

Akademia gjithashtu synoi t'u prezantojë pjesëmarrësve procesin e përgjithshëm zgjedhor dhe të inkurajojë dhe edukojë anëtarët e rinj të partisë për të kontribuar në një shprehje më të saktë të ideve dhe koncepteve të tyre për një shoqëri më të mirë dhe një hapësirë publike demokratike pluraliste. Pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë se si krijohen politikat publike, si ndikohen ato dhe si zbatohet një qasje e bazuar në dëshmi në politikëbërjen publike. Qëllimi u arrit duke kombinuar pjesët teorike mbi temat e politikëbërjes dhe përvojën praktike me përfshirjen e komunitetit lokal në krijimin e përgjigjeve të politikave ndaj nevojave të qytetarëve. Një nga këto aktivitete shtesë të Akademisë është zhvillimi i dokumenteve të shkurtra të politikave nga secili pjesëmarrës. Përkatësisht, drejtuesit e rinj, pjesëmarrësit e Akademisë, menjëherë pas përfundimit të modulit të parë, kanë identifikuar një sfidë që duan të adresojnë duke propozuar zgjidhje përmes politikave.

Përshtypjet e një pjesëmarrësi të Akademisë: "Jam shumë i emocionuar që jam pjesë e Akademisë për politika publike". Është e vetmja Akademi në shtet që shkon përtej mësimdhënies në klasë/punëtori! Më ndihmon të "mësoj duke bërë" dhe të na inkurajoj ne, anëtarët e partisë, të jemi me komunitetin tonë, të flasim me më të prekurit dhe të propozojmë zgjidhje duke bazuar në nevojat e qytetarëve.

Dokumentet e shkurtra të politikave publike të këtij publikimi përfaqësojnë shtrirjen përfundimtare të përpjekjeve të përfaqësuesve të forumeve rinore politike për të krijuar politika të bazuara në dëshmi dhe vlera. Këto dokumente të shkurtra u zhvilluan për të propozuar zgjidhje përkatëse të orientuara nga qytetarët që do të përfshiheshin në programet zgjedhore të partive politike. Këto aktivitete do t'u japin pjesëmarrësve një mundësi për të aplikuar njohuritë dhe aftësitë e fituara, në situata të jetës reale dhe përmes angazhimit me qytetarët.

Ata kryen hulumtime, si dhe konsultime me palët e interesuara dhe komunitetin e prekur.

Ne inkurajojmë partitë politike të integrojnë dokumentet e shkurtra të politikave publike në programet e tyre, pasi ato mund të dëshmojnë të jenë një pasuri e vlefshme për strategjinë aktuale dhe të ardhshme të qeverisjes. Përfshirja e dokumenteve të shkurtra të politikave publike mund të ndihmojë partitë politike të demonstrojnë angazhimin e tyre për transparencë, llogaridhënie, vendimmarrje të bazuar në dëshmi dhe angazhim publik. Gjithashtu mund të çojë në procese më efektive dhe të mirëinformuara të hartimit të politikave, nga të cilat në fund të fundit përfiton vendi dhe qytetarët e tij. Së pari, dokumentet e shkurtra të politikave publike ndihmojnë partitë në komunikimin e ideve të tyre në mënyrë efektive si për anëtarët e tyre ashtu edhe për publikun e gjerë, duke nxitur një elektorat më të informuar dhe të angazhuar. Për më tepër, dokumentet e shkurtra të politikave mund të jenë mjete të vlefshme për llogaridhënie, pasi ato ofrojnë të dhëna të qarta të premtimeve dhe pozicioneve të një partie, duke i lejuar votuesit t'i mbajnë ata llogaridhënës për veprimet e tyre pasi të jenë në pozitë. Për më tepër, ata kontribuojnë në shëndetin dhe efektivitetin e sistemeve demokratike duke siguruar që partitë politike të përqendrohen në politika të bazuara në dëshmi që i shërbejnë interesit publik. Në përgjithësi, përdorimi i këtyre dokumenteve të shkurtra të politikave publike rrit transparencën, komunikimin dhe llogaridhënien në procesin politik, duke i bërë ato një shtesë të vlefshme në programet e çdo partie.

Vazhdimësia e publikimit tregon dokumentet e shkurtra të politikave publike, të cilat përfshijnë format dhe mënyrat e përfshirjes së komunitetit lokal në identifikimin e problemeve, si dhe propozimet për zgjidhjen e mundshme të tyre. Radhitja e dokumenteve të shkurtra të politikave publike bëhet sipas rendit alfabetik të komunave në të cilat u zhvilluan angazhimet e komunitetit.

Mbledhja e dokumenteve për politikat publike, e zhvilluar nga pjesëmarrësit e Akademisë së dytë për politikat publike, është në dispozicion onlajn në linkun e mëposhtëm

<https://electoralreforms.mk/wp-content/uploads/2021/12/Compendium-of-policy-briefs-2021.pdf>

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Aerodromit

1. Vendparkime të pamjaftueshme në Komunën e Aerodromit - Valentin Manasievski (VMRO-DPMNE)





VENDPARKIME TË
PAMJAFTUESHME NË
KOMUNËN E AERODROMIT

**„Недовољно паркинг места
во општина Аеродром“**

**"Numër i pamjaftueshëm i vendparkimeve
në komunën e Aerodromit"**

**Valentin Manasievski
- VMRO-DPMNE -**



Përmbledhja

Dokumenti i Valentinit e trajton problemin e numrit të pamjaftueshëm të parkingjeve në komunën e Aerodromit. Në një takim me autoritetet komunale, është propozuar që të bëhet një anketë me qytetarët e Aeroportit të vjetër dhe Lisiçes së re, dy vendbanimet më të prekura me këtë problem në komunë, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të përshtatshme. Rezultatet e sondazheve treguan se zgjidhja më e mirë do të ishte vendosja e parkimit zonal, me përjashtim të rrugës ASNOM.

Komuna e Aerodromit zyrtarisht është shpallur komunë në vitin 2013, ndërsa më parë, territori i Komunës së Aerodromit ka qenë në kuadër të Komunës së Kisella Vodës. Komuna ka 77,735 banorë, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 21km² me 8 vendbanime³.

Në komunën e Aerodromit, një nga problemet me të cilat përballen qytetarët është mungesa e vendparkimeve. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistika, në territorin e Komunës së Aerodromit janë regjistruar gjithsej 26,352 automjete pasagjerësh⁴. Problemi ka të bëjë me mungesën e parkimit në zona të caktuara, për shkak të faktit se disa banorë nuk kanë blerë vendparkim në vendin ku banojnë, ose e kanë një të tillë, por e kanë më të përshtatshme ta parkojnë automjetin e tyre diku tjetër.

Me këtë sjellje të pandërgjegjshme para së gjithash kërcënohet qarkullimi i këmbësorëve, çiklistëve dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion. Gjithashtu, në sipërfaqet publike shkaktohen dëme materiale, si dhe shkatërrohet gjelbërimi dhe dëmtohet mjedisi jetësor⁵.

Për qëllimet e këtij dokumenti, analiza u përqendrua në dy lokalitete, njëra në rajonin e Lisiçes së Re, ndërsa tjetra në Aerodromin e Vjetër. Në të dy lokalitetet paraqet problem mungesa e vendparkimeve. Në njërën pjesë të Lisiçes së Re, madje ka parking të montuar në një kat, por as ky nuk e zgjidh problemin.

Në bisedë me shërbimet komunale, u theksua se edhe ata e kanë identifikuar këtë problem, veçanërisht në komunat e lartpërmendura dhe janë plotësisht të hapur për bashkëpunim dhe për gjetjen e përbashkët të zgjidhjes afatgjate të problemit.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Në takimin e zhvilluar me autoritetet vendore, u propozua të kryhet një anketë me qytetarët e Aerodromit të Vjetër dhe Lisiçes së Re se, vallë pajtohen me vendosjen e parkimit zonal në vendbanime. Në bashkëpunim me autoritetet

³ Profili i komunës së Aerodromit, <http://www.aerodrom.gov.mk/page/portret#>

⁴

https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_Transport_RegistriraniVozila/275_Trans_Reg_voz_Gorivo_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=63d13bd1-5691-4a1f-b607-4642a307515d

⁵ <https://www.porta3.mk/vo-aerodrom-vozila-parkirani-na-javni-povrshini-opshtinata-apelira/>

komunale u përpiluan pyetësorët, ndërsa komuna mori përgjegjësinë që t'i zbatojë të njëjtit me qytetarët. Në rrugën „Angell Dimovski” në Aerodrom u zbatuan 24 anketa, në rrugën „Jane Sandanski” po ashtu në Aerodrom u zbatuan 34 anketa, ndërsa në lagjet e Lisiçes së Re u zbatuan anketat në rrugën „Kosta Novakoviç”, 70 anketa, dhe në rrugën ASNOM, u anketuan 27 të anketuar. Anketa është hartuar në këtë mënyrë: A do të pajtoheshit të ketë parkim zonal ku banorët rezidentë do të merrnin një vendparkim falas, në qoftë se do të kenë një automjet të dytë çmimi të jetë simbolik 1000 denarë në vit, ndërsa për banorët jo rezidentë vendparkimi të kushtojë 25 denarë për një orë parkim.

Në rrugët Angell Dimovski, Kosta Novakoviç dhe Jane Sandanski shumica e qytetarëve pajtohen me vendosjen e parkingut zonal, ndërsa qytetarët e rrugës ASNOM janë kundër vendosjes së parkimit zonal. Një nga zgjidhjet për rrugën ASNOM do të ishte vendosja e një garazhi të montuar në fund të rrugës, me çka do të siguroheshin dyfish më shumë vende për parkim si për banorët ashtu edhe për vizitorët. Në rajonet Lisiçe e Re 2 dhe Aeroporti i Vjetër, me iniciativë të Këshillit Komunal të Aerodromit, do të inicohet vendosja e parkimit zonal me përfitim për banorët vendas, respektivisht çdo banesë do të ketë vendparkim të saj in të shënuar me numër, e nëse dikush dëshiron të marrë një tjetër, do të duhet të paguajë një çmim simbolik prej 1000 denarësh në vit. Në këtë mënyrë do të rregullohet rrëmuja e komunikacionit me të cilën përballen banorët e kësaj komune.

Në periudhën e ardhshme me propozim të grupit këshillëdhënës të VMRO-DPMNE-së do të jepet propozim për vendosjen e parkingut zonal dhe i njëjti do të propozohet në seancën e Këshillit të Komunës së Aerodromit. Po ashtu, propozimi për rrugën ASNOM do t'u prezantohet këshilltarëve dhe palëve të tjera të prekura.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Berovës

1. Transporti rajonal dhe lokal në Berovë - Angella Zdravkovska (VMRO-DPMNE)



TRANSPORTI RAJONAL DHE LOKAL NË BEROVË



„Меѓуградски и локален превоз во Берово“

“Transporti rajonal dhe lokal në Berovë”

**Angella Zdravkovska
- VMRO-DPMNE -**



Përmbledhja

Dokumenti i Angelës për politika publike trajton problemin e mungesës së transportit rajonal dhe lokal në Berovë. Për të hulumtuar problemin dhe për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme, ajo kreu një sondazh online me 82 të anketuar. Nga të gjitha problemet e radhitura, pjesa më e madhe e të anketuarve, 58,5%, si problem kryesor kanë theksuar transportin publik në Berovë. Si zgjidhje të mundshme, qytetarët kanë sygjerruar që komuna të sigurojë partneritet publiko-privat me bizneset vendore që do të ofrojnë shërbime transporti në rajonin e komunës së Berovës.

Berova është qytet në pjesën lindore të vendit tonë i cili shtrihet në shpatet e maleve të Maleshevisë dhe sipas regjistrimit të fundit të vitit 2021 numëron 10890 banorë, dhe është i njohur për nga bukuritë e veta dhe mundësitë turistike. Edhe pse Berova është qytet i vogël, ai ka disa probleme me të cilat përballet. Një nga problemet kryesore është lënia pas dore e qytetit dhe e fshatrave përreth, që sjell në shpërfilljen e trashëgimisë kulturore dhe historike dhe rrjedhimisht zvogëlimin e numrit të turistëve. Ekzistojnë edhe probleme të tjera në Berovë, siç janë: gjendja jo e mirë e rrjetit rrugor, mungesa e infrastrukturës për furnizim me ujë dhe kanalizimi, si dhe sfidat socio - ekonomike për shkak të mungesës së vendeve të punës dhe perspektivave të rinisë. Kultura dhe kultura infrastrukturore, cilësia e ujit të pijshëm, deponitë e paligjshme dhe transporti rajonal dhe lokal (nga Berova me fshatrat përreth dhe anasjelltas) janë gjithashtu një nga problemet kyçe në Berovë.

Për të hulumtuar problemin dhe për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme, u zbatua një sondazh onlajn, me 82 të anketuar. U theksuan katër probleme kryesore, ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve, përkatësisht 58.5%, e veçuan si problem më të madh çështjen e mungesës së transportit rajonal dhe lokal në Berovë. Krahas opsioneve të ofruara, atyre iu parashtrua një pyetje e përgjithshme: qytetarët të shkruajnë për problemet e tyre.

Pas afro 20 vjet punë të suksesshme me linja më të shpeshta të transportit të autobusëve, pjesa lindore u shkëput nga shteti. Stacioni i vetëm i autobusëve i cili e mbante tërë rajonin (Berovë, Pehçevë, Delçevë, Vinicë dhe Kamenicë me fshatrat përreth) pushoi së vepruari brenda natës. Për shkak të disa arsyeve, për ne qytetarët të panjohura, leja për punë dhe kryerja e transportit nuk janë vënë në funksion.

Pasi nxitëm problemin me transportin publik dhe takimet e zhvilluara, përfshirë takimin me Ministrinë e transportit dhe lidhjeve, Komuna e Berovës në mbledhjen e saj të 24-t miratoi vendim me të cilin fillon të zbatohet transporti publik falas, në territorin e Maqedonisë, çdo të enjte, duke filluar me datë 06.04.2023.

Transporti do të kryhet me autobus, i cili është në pronësi të Komunës së Berovës në linjat e mëposhtme:

1. Dvorishtë – Ratevë – Rusinovë – Vlladimirovë – Berovë; nisja në orën 07:30 (nisja nga qendra e fshatit) dhe kthimi Berovë – Vlladimirovë – Rusinovë – Ratevë –Dvorishtë; nisja në orën 13:00.
2. Mitrashincë – Budinarcë – Maçevë – Smojmirovë; nisja në orën 10:00 (nisja nga qendra e fshatit) dhe kthimi Berovë – Smojmirovë – Maçevë – Budinarcë – Mitrashincë; nisja në orën 15:00.

Të gjithë ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë transportin falas ditën e enjte, duhen të lajmërohen në numrin telefonik të Komunës së Berovës, 033/471-057, të martën, prej orës 08.30-13.30.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Kjo zgjidhje nuk është përfundimtare, dhe sipas shumicës së banorëve është e parealizueshme dhe kufizuese, duke marrë parasysh se ky transport organizohet vetëm të enjten (ditë tregu në Berovë). Njerëzit e fshatit kanë nevojë reale për një linjë lokale që t'ua bëjë të mundur kryerjen e punëve të ndryshme gjatë udhëtimit prej fshatit në qytet dhe anasjelltas për nevojat e veta (shëndetësore, administrative, të pagesave).

Nevoja e transportit rajonal dhe lokal është e madhe dhe kjo gjë vërteton faktin se transporti i organizuar në oraret e lartpërmendura mbushet shpejt.

Një zgjidhje e mundshme për problemin me transportin rajonal dhe lokal në Berovë mund të jetë përfshirja e transportuesve privatë, përmes partneritetit publiko-privat me komunën, të cilët do të ofronin shërbime transporti në atë rajon. Kjo mund të arrihet me anë të marrëveshjes ndërmjet komunës dhe sektorit privat, i cili do të mundësojë kontroll dhe rregullim të shërbimeve të transportuesve.

Zgjidhje tjetër është themelimi i ndërmarrjes publike nga ana e komunës dhe furnizimi i autobusëve/furgonave. Kjo zgjidhje është më pak e realizueshme, për shkak të mungesës së kapaciteteve të komunës, si financiare ashtu dhe njerëzore.

Propozim-zgjidhjet e ofruara për këtë problem pritet të shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Komunës, me qëllim që të arrihet zgjidhje përfundimtare dhe e qëndrueshme e problemit në fjalë.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Manastirit

1. Manastiri me qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale - Mario Janevski (E Majta)



MANASTIRI ME QENDËR DITORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE



**„Битола со дневен центар за лица
со интелектуална попреченост“**

**"Manastiri me qendër ditore për personat
me aftësi të kufizuara intelektuale"**

**Mario Janevski
- E Majta -**



Përmbledhja

Ky dokument trajton problemin e mungesës së qendrës ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale në Manastir. Për të hulumtuar këtë problem, Mario zhvilloi takime me zyrtarë dhe këshilltarë të komunës, si dhe familjarë të personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Si konkluzion u vendos që një nga këshilltarët të dorëzojë propozim në Këshillin e Komunës së Manastirit për fillimin e procesit për specifikimet teknike dhe për gjetjen/hartëzimin e objekteve në kompetencë të Komunës.

Vendi ynë në vitin 2011 nënshkroi dhe ratifikoi Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por në thelb është larg zbatimit real të reformave të cilat do të ndihmojnë këtë grup qytetarësh të marginalizuar, siç praktikohet në pjesën më të madhe të vendeve anëtare të UE-së.

Në Manastir ekziston klubi i krijimtarisë dhe edukimit të cilin e themeloi shoqata „Poraka”. Në bisedë me palët e interesuara, përfaqësues të shoqatës dhe anëtarë të familjeve të personave me aftësi të kufizuara intelektuale u konstatua se atyre u nevojitet sigurimi i hapësirës që do të përdoret si qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale.

Manastiri është një nga komunat më urbane në Maqedoni, ndërsa kjo komunë në territorin e vet nuk ka hapur qendra të këtij tipi të cilat pa dyshim nevojiten që t’ua lehtësojnë funksionimin e përditshëm personave me aftësi të kufizuara intelektuale, por edhe familjeve të tyre. Mungesa e qendrave ditore për qëndrim, punë dhe socializim të personave me aftësi të kufizuara intelektuale i sjell personat dhe familjet e tyre në gjendje marginalizimi të skajshëm dhe fizikisht i përjashton nga mënyra normale e jetesës. Si rrjedhojë e kësaj, këto familje nuk mund t’u sigurojnë fëmijëve shoqërimin, daljen nga shtëpia, nuk mund t’u përkushtohen si duhet as fëmijëve tjerë të familjes, problemeve të tyre shëndetësore, ndërsa së paku njëri prind në familje nuk mund të punojë dhe të fitojë, për shkak se ia përkushton tërë ditën personit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe rrjedhimisht, nuk mund të krijojë marrëdhënie të rregullt pune. Vetëm me një rrogë, gjithnjë e më vështirë përballen shpenzimet, të cilat janë më të mëdha për dallim nga nevojat dhe shpenzimet në familjet ku nuk ka person me aftësi të kufizuara. Krahas gjithë kësaj, familje të tëra ndodhen në kushte të jetës së padurueshme psikike dhe të funksionimit.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Themelimi i qendrës ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale në Komunën e Manastirit është zgjidhje e vetme për këtë kategori të cenueshme, por edhe për të afërmit e tyre. Shoqata “Poraka” është e gatshme të ofrojë mbështetje të plotë profesionale, si për kapacitetet intelektuale të zhvillimit në pjesën programore, ashtu edhe për pajisjen e qendrës me ndihmën e donacioneve të ndryshme, ndërsa komuna do të sigurojë hapësirën dhe do të mbulojë shpenzimet për funksionimin e kësaj qendre.

Në bisedë e sipër me këshilltarët dhe përfaqësuesit e tjerë të vetëqeverisjeve lokale, ku tashmë ekziston qendra ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, ata shkëmbyen përvojat për tërë procesin e themelimit të qendrës së këtij tipi. "Pikësëpari Komuna duhet të zbatojë specifikimin teknik për nevojat e qendrës (sa metër katrorë hapësirë nevojitet, përqasja e objekteve, kushtet plotësuese që ka hapësira) dhe të lokalizojë objekte të caktuara që janë në kompetencë të komunës dhe që i plotësojnë kushtet e sipërme. Pastaj në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) të vendoset komunikimi për hapat e ardhshëm për funksionimin e qendrës", deklaruan shumica e këshilltarëve.

Në bashkëpunim me grupin e këshilltarëve të Komunës së Manastirit u diskutua kjo temë dhe u mor vendim që njëri nga këshilltarët ta dorëzojë propozimin në Këshillin e Komunës së Manastirit, me qëllim të nisë procesi i specifikimit teknik dhe të lokalizohen objektet që janë në kompetencë të komunës. Po ashtu, u mor vendim, pasi që komuna ta ketë zbatuar procesin e specifikimit teknik dhe lokalizimin e objekteve, të caktohet takim në MPPS që të shqyrtohen hapat e mëtejshëm për funksionimin e qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Bërvenicës

1. Këshilli rinor lokal në Komunën e Bërvenicës - Adem Jashari (Alternativa)



KËSHILLI RINOR LOKAL NË KOMUNËN E BËRVENICËS



**„Формирање на локален младински совет
во општина Брвеница“**

**“Formimi i këshillit rinor lokal
në komunën e Bërvenicës”**

**Adem Jashari
- Alternativa -**



Përmbledhja

Ky dokument i politikave publike trajton problemin e mosekzistencës së këshillit rinor lokal në komunën e Bërvenicës, që është obligim ligjor për çdo komunë në Maqedoninë e Veriut. Pas hulumtimit të problemit dhe një sërë takimesh dhe në koordinim me kryetarin e komunës, zyrtarin për të rinjtë në komunë dhe një grup këshilltarësh, procesi është në fazën e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit rinor vendor.

Komuna e Bërvenicës është komunë në veriperëndim të Maqedonisë së Veriut, dhe është pjesë e rajonit të Pollogut. Bërvenica i përket komunave rurale dhe përfshin 10 vendbanime, të organizuara në 11 bashkësi lokale me gjithsej 13645 banorë sipas regjistrimit të fundit të popullatës. Migrimi si proces ka lënë shumë pasoja, ku një ndër to është edhe ulje e madhe e numrit të popullatës së të rinjëve. Të rrinjë të moshës 15-29 vjet, ashtu sic është e definuar edhe në ligj, ka gjithsej 2853 banorë, që përbën afër 21% të popullsisë nga numri i përgjithshëm.

Me ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore të miratuar më 14 janar 2020, secila komunë e ka obligim të formojë Këshillin Rinor në përputhje me dispozitat ligjore dhe ai Këshill Rinor të punojë sipas parimit të Këshillit të Komunës⁶.

Si rezultat i mospasjes së këshillit rinor lokal në Komunën e Bërvenicës, të rinjtë nuk kanë mekanizëm për t'u kycur në processin e vendimarrjes, në vecanti në krijimin e politikave publike rinore. Të rinjtë gjithashtu nuk janë të informuar edhe për rolin e këshillit rinor lokal në krijimin e politikave rinore në Komunën e Bërvenicës.

Qysh nga fillimi i mandatit të Kryetarit të Komunës, këshilltarët komunal, kanë biseduar këtë çështje dhe kanë rënë dakord që sapo të procesohen ca prioritete lokale të nisë edhe procesi për formimin e Këshillit rinor. Para përfundimit të vitit 2022, në bisedë me Kryetarin e komunës, u potencua edhe njëherë kjo çështje dhe u premtua se këshilltarët komunal do jenë të kyçur në procesin e monitorimit dhe mbështetjes së këtij procesi për zyrtarin për të rinjtë që e udhëheq këtë proces.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Këshilli rinor është një platformë që mundëson një bashkëpunim të ngushtë midis të rinjve dhe autoriteteve lokale në zgjidhjen e sfidave dhe problemeve të ndryshme që prekin të rinjtë në komunitetin e tyre. Ligji për pjesëmarrjen rinore parashikon pjesëmarrjen aktive të të rinjëve në procesin e krijimit të politikave rinore dhe vendimmarrjes në nivel lokal. Kjo mundëson një pjesëmarrje më aktive të të rinjëve në jetën publike dhe në vendimmarrjen e rëndësishme që ndikon në jetën e tyre të përditshme.

⁶ Ligji për pjesëmarrje rinore: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

Themelimi i këshillit rinor lokal përpos që do jetë si mekanizëm kryesor në kycjen e të rinjëve në procesin e vendimarrjes në nivel lokal, gjithashtu do të jetë edhe urë komunikimi ndërmjet të rinjëve dhe shumë institucioneve tjera relevante në nivel lokal. Problemet dhe nevojat e të rinjëve do të adresohen nëpërmjet këshillit rinor lokal.

Pas takimit të fundit me Kryetarin e komunës, ku gjetëm mbështetje të madhe për këtë çështje, se bashku me zyrtarin për të rinjtë u realizuan takime të vecanta me palë të ndryshme të cilat janë kyce për këtë proces, si: përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues të forumeve rinore politike, aktivistë dhe të rinjë të motivuar që dëshirojnë të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e kësaj problematike. Gjithmonë, në bashkëpunim me zyrtarin për të rinjtë u përgatit dhe u hap thirrja për të rinjtë që të kycen në këtë proces.

Ajo që duhet ti paraprijë procesit është zbatimi i një kampanje informuese për të rinjtë në të gjithë vendbanimet e komunës me qëllim të informimit mbi rolin e këshillit rinor lokal. Iniciativa këto të cilat kërkojnë koordinim nga zyrtari për të rinjtë në bashkëpunim me kryesuesit të këshillit, këshilltarëve të tjerë dhe kryetarin të komunës.

Përveç kampanjës, procesi duhet të vazhdon me konsultimin e palëve të kycura të cilët do të japin mendimet e tyre rreth nevojave dhe interesave të rinisë dhe sa janë ato të përfaqësuar dhe të marrë parasysh në vendimmarrjen lokale.

Këshilli rinor mund të ndihmojë në nxitjen e kreativitetit dhe inovacionit të të rinjve, duke ndihmuar në rritjen e nivelit të angazhimit dhe përgjegjësisë së tyre ndaj komunitetit dhe vendit të tyre.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Butelit

1. Problemet ekologjike të lumit Serovë në Komunën e Butelit - Boris Petrovski (RDM)

2. Problemi me qentë e pastrehë në komunën e Butelit - Xhuneit Rushid (Lëvizja për bashkin kombëtar te Turqve)



PROBLEMET EKOLOGJIKE TË LUMIT SEROVË NË KOMUNËN E BUTELIT



„Еколошки проблеми со реката Серова“

"Problemet ekologjike me lumin Serovë"

**Boris Petrovski
- RDM -**



Përmbledhja

Ky dokument e trajton aspektin ekologjik të lumit Serovë në komunën e Butelit. Për këtë çështje janë konsultuar Kryetari i komunës, këshilltarë dhe qytetarë. Zgjidhjet e propozuara për problemet ekologjike të lumit Serovë në Komunën e Butelit përfshijnë ndërgjegjësimin e publikut për mos hedhjen e mbeturinave, rritjen e inspektimeve dhe vendosjen e gjobave për hedhjen e mbeturinave, si dhe rregullimin e zonës përreth lumit me gjelbërim dhe me stola për pushim.

Komuna e Butelit ndodhet në periferi të pjesës veriore të Shkupit me një popullsi prej 37.968 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2021 . Para afro 15 vjetësh në lagjen e Butelit lumi Serovë ishte i pasur me florë dhe faunë. Mirëpo për shkak të mos mirëmbajtjes dhe ndotjes nga ana e banorëve, bota shtazore është në prag të zhdukjes dhe rrjedha e lumit ka devijuar. Gjithashtu, për shkak të faktit se hidhen çdo lloj materiale ndërtimore dhe mbeturinash prej qytetarëve, ka ardhur deri te zënia e shtratit të lumit Serovë. Gjatë shirave të rrëmbyeshëm, në vitin 2001 kishte vërshime, që goditi qytetarët e këtij vendbanimi, por për shkak të mosndërmarrjes së aktiviteteve për tejkalimin e sfidave, mirëmbajtjes jo të rregullt dhe infrastrukturës jo adekuate të shtratit të lumit, rreziku nga vërshimet ende ekziston.


Problem shtesë është dalja e ujërave nga kanalizimet e shtëpive dhe rrjedhja e tyre në lumë që ndodhen në pjesën perëndimore të shtratit të lumit dhe kjo shkakton ndotje dhe rrezik për shëndetin e qytetarëve. Për shkak të erës kundërmuese të kanalizimit dhe hapësirës së parregulluar pranë shtratit të lumit, qytetarët nuk mund ta shfrytëzojnë atë pjesë për shëtitje dhe rekreacion.

Këto probleme u identifikuan edhe në bisedë me qytetarët të këtij vendbanimi, të cilët deri diku janë të kënaqur me pastrimin e lumit, por megjithatë theksojnë se kjo zgjidhje nuk është e qëndrueshme.

Këto janë problemet kryesore që janë identifikuar:

- Vetëdije e ulët e qytetarëve, që hidhen materialet ndërtimore dhe mbeturinat në shtratin e lumit;
- Mbikëqyrje e pamjaftueshme inspektimi në terren, te shtëpitë që lënë ujërat e kanalizimit të rrjedhin në shtratin e lumit;
- Hapësirë jo e rregulluar përgjatë shtratit të lumit me gjelbërim dhe ulëse, që më pas kjo hapësirë të përdoret për shëtitje dhe rekreacion.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Gjatë procesit të identifikimit të problemeve u përfshinë disa palë të prekura, d.m.th., qytetarët, shërbimi komunal dhe këshilltarët. U vërtetuan problemet e sipërme, dhe në bisedë me komunën u ofruan këto zgjidhje:

- Realizimi i një fushate vetëdijesimi të qytetarëve që të mos hedhin mbeturina dhe materiale ndërtimore në shtratin e lumit;

- Të rritet mbikëqyrja inspektuese, sidomos në lagjen ku qytetarët lëshojnë ujërat e kanalizimit në shtratin e lumit dhe të ketë dënime përkatëse
- Dorëzimi në shërbimet komunale i propozimit për rregullimin e hapësirës përgjatë shtratit të lumit me fidanë, gjelbërim dhe ulëse.

Propozim-zgjidhjet u pranuan pozitivisht nga të gjitha palët e interesuara: qytetarët, shërbimi komunal dhe këshilltarët. Kryetari i komunës premtoi se mbikëqyrjet inspektuese në të ardhmen do të jenë më të shpeshta, por në këtë rast kërkon mbështetje edhe nga qytetarët, që të raportojnë në shërbimet përkatëse çdo lloj shkeljeje të kryer. Për këtë gjë ekziston numri telefonik ku mund të bëjnë raportimin e rasteve.

Si plotësim, në bashkëpunim me qytetarët, do të përgatitet propozim-plani për rregullimin e hapësirës përgjatë shtratit të lumit me fidanë, gjelbërim dhe ulëse. Propozimi do të futet në rendin e ditës në seancën e Këshillit dhe kur do të miratohet, shërbimet komunale do ta shqyrtojnë menjëherë.

PROBLEMI ME QENTË E PASTREHË NË KOMUNËN E BUTELIT



**„Бездомни кучиња
во општина Бутел“**

**"Qentë e pastrehë
në komunën e Butelit"**

**Xhuneit Rushid
- Lëvizja për bashkin
kombëtar te Turqve -**



Përmbledhja

Ky dokument i politikave publike trajton problemin e qenve të pastrehë në komunën e Butelit, të cilët qarkullojnë lirshëm dhe kërcënojnë jetën e qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve. Për këtë problem, Xhuneiti u takua me qytetarë, zyrtarë komunalë dhe këshilltarë. Për zgjidhjen e tij, dokumenti trajton dhe ofron si zgjidhje këto alternativa: ngritjen e një organi koordinues që do të bashkëpunojë drejtpërdrejt me organizatat joqeveritare dhe qytetarët, regjistrimi i qenve endacakë të vaksinuar ose caktimi i një personi përgjegjës-koordinator i aktivitetet e këtij problemi.

Si një nga gështjet më aktuale të dekadave të fundit në vend, në qytetin e Shkupit dhe konkretisht në komunën e Butelit është trajtimi i problemit të qenve të pastrehë, të cilët qarkullojnë lirshëm në rrugë, kërcënojnë jetën e qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve. Me këtë problem po ballafaqohemi edhe në nivel ditor. Shpesh herë në media jemi dëshmitarë të sulmit të qenve endacakë ndaj njerëzve me lëndime të lehta, apo edhe më të rënda⁷. Procedura për zgjidhjen e problemit është shumë komplekse, por qytetarët përpiqen në mënyrë individuale t'i zgjidhin problemet e veta (vaksinimi i të plagosurit, identifikimi i qenit sulmues, raportimi i rastit në polici etj.). Shoqata për mbrojtjen e kafshëve „Anima Mundi” , është një organizatë që kujdeset për trajtimin dhe mbrojtjen e kafshëve dhe tashmë gjatë kohë jep propozime për trajtimin e qenve të pastrehë. Megjithatë, problemi ende është aktual dhe nuk është gjetur zgjidhja për të.

Në bisedë të drejtpërdrejtë me prindërit e SHF „ Peter Zdravkovski Penko” në territorin e komunës së Butelit, është shprehur shqetësim i madh për sigurinë e fëmijëve të tyre të mitur. Me fjalë të tjera, jo rrallë ndodh edhe në rrethin shkollor të ketë sulme nga qentë endacakë. Janë vërejtur disa sulme të qenve ndaj nxënësve edhe gjatë ardhjes në shkollë. Në pyetjen drejtuar prindërve se a janë paraqitur rastet në polici dhe në shërbimet përkatëse u morën përgjigje negative sepse nuk janë të informuar për procedurat në rastet e këtilla.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Komuna si përgjegjëse për qytetarët e vet duhet të ndërmarrë hapa konkretë lidhur me këtë problematikë.

Në lidhje me zgjidhjen e problemit aktual, rekomandohet që komuna e Butelit të marrë përsipër këto masa:

- krijimi i trupit koordinues i cili do të jetë platformë për bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të organizatave qytetare, shoqatave qytetare dhe individëve me përvojat e tyre;
- nisma për procesin e regjistrimit të qenve të pastrehë të vaksinuar dhe të pa vaksinuar në komunë.
- emërimi i personit përgjegjës/koordinator i aktiviteteve.

⁷ <https://netpress.com.mk/petgodishnik-i-vozasna-zhena-napadnati-od-kuchi-a-vo-skop-e/>

Në bashkëbisedim me grupet këshilluese, të cilat tregojnë interesim të madh për problemin në fjalë, janë marrë propozime konstruktive për trajtimin e çështjes së qenve të pastrehë. Një nga propozimet është që të ndërtohet një qendër kolektive trajtimi në territorin e komunës së Butelit, për përkujdesjen e qenve të pastrehë. Por, në të njëjtën kohë dhe në kontaktet me qytetarët, me kafshëdashësit të njëjtit duhet të strehohen, e më përpara duhet të vaksinohen plotësisht dhe të marrin trajtim adekuat mjekësor. Ky propozim ka mbështetje edhe nga organizatat joqeveritare, të cilat do të kontribuojnë me anë të përvojës dhe njohurive të tyre për suksesin e projektit.

Propozimet e lartpërmendura u janë dorëzuar këshilltarëve për shqyrtim dhe do të vendosen në rendin e ditës në seancën e ardhshme të Këshillit të Komunës.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Gazi Babës

1. Betonimi i kanalit si zgjidhje prioritare nga ana e autoriteteve lokale - Abduselam Kamberi (BDI)

2. Qentë e pastrehë në Komunën e Gazi Babës - Viktorija Smilkovska (PLD)



BETONIMI I KANALIT SI ZGJIDHJE PRIORITARE NGA ANA E AUTORITETEVE LOKALE



**„Уредување/бетонирање на каналот
во населба Сингелиќ“**

**"Betonimi/rregullimi i kanalit
ne lagjen Hasanbeg"**

**Abduselam Kamberi
- BDI -**



Përmbledhja

Dokumenti i Abduselamit e trajton problemin e kanalit të ujërave të zeza si prioritet për t'u zgjidhur në në lagjen e Hasanbegut. Përmes një sondazhi me më shumë se 100 qytetarë, zgjidhja e problemit për kanalën është cilësuar si urgjent. Ai u takua edhe me një nga këshilltarët e komunës, ku u ra dakord që sa më shpejt të vihej në rend dite kjo çështje dhe të gjendet një zgjidhje, p.sh. betonimi i shtratit të kanalit dhe rregullimi i gjelbërimit pranë tij.

Lagjja Hasanbeg (maq. Singeliq) është pjesë e Komunës së Gazi Babës dhe sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, numëron rreth 7800 banorë⁸.

Kanali i cili kalon nëpër lagjen Hasanbeg dhe nëpërmjet të cilit kalojnë ujërat e zeza nga shtëpitë, bizneset dhe industri të ndryshme, është një burim i madh problemesh për komunitetin. Kanali, që është rreth 4 kilometra i gjatë dhe shtrati i të cilit nuk është i betonuar, shkakton shpeshherë probleme në lagjen ku kalon, duke u bërë burim i ndotjes së mjedisit dhe kërcënimit të shëndetit publik. Në fakt, pasi që kanali nuk është i betonuar, ujërat e zeza dalin në sipërfaqe dhe hyjnë nëpër shtëpitë e lagjes, duke shkaktuar probleme serioze në higjienën dhe shëndetin e banorëve.

Gjithashtu ky problem u identifikua edhe nga vetë qytetarët nëpërmjet një ankete të realizuar me mbi 100 të anketuar. Mbi 90% e të anketuarëve, nga të gjitha problemet të cilat qytetarët ballafaqohen, ata i dhanë prioritet problemit me kanalin. Përveç anketës, u zbatuan edhe një sërë bisedash me qytetarët, me ç'rast ata potencojnë se shumë herë deri te autoritetet e kanë ngritur këtë çështje dhe se kërkojnë zgjedhje të shpejte të këtij problemi po edhe të problemeve tjera infrastrukturore të cilat varen nga betonimi i kanalit në fjalë.

Poashtu Në bashkëbisedim me këshilltarin nga rradhët e Lëvizjes BESA, i cili është i vetmi këshilltar shqiptar në këtë formacion të Këshillit komunal, erdhëm në përfundim se kjo paraqet problem kyc për banorët.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Zgjidhja e vetme e këtij problemi është betonimi i kanalit i cili është në gjatësi prej 4 km. Gjatë anketës, qytetarët shprehën gjithashtu opinionin se përpos betonimit, duhet të investohet edhe në gjelbërimin e asaj pjese përreth kanalit dhe është si opcion me i votuar nga qytetarët.

Në këtë kontekst, propozoj që komuna të ndërmarrë veprime për të betonuar kanalin e ujrave të zeza, për të minimizuar ndotjen e mjedisit dhe rrezikun për shëndetin publik.

⁸ <https://www.stat.gov.mk/Aktivnosti.aspx?rbra=331>

Betonimi i kanalit do të ndihmojë në parandalimin e daljes së ujërave të zeza në sipërfaqe dhe do të ulë shkallën e kërcënimit për banorët e lagjes si nga aspekti shëndetësor i përmendur më lartë, po edhe nga aspekti i mjedisit jetësor dhe pastërtisë së truallit dhe produkteve të cilat kultivohen aty.

Kjo veprimtari do të kushtojë një shumë të caktuar të parave, por përfitimet afatgjata të këtij investimi do të jenë të jashtëzakonshme. Përveç kësaj, betonimi i kanalit do të krijojë një ambient të pastër dhe të sigurtë për banorët e lagjes, duke rritur cilësinë e jetës së tyre dhe duke ndikuar në rritjen e vlerës së pronave të tyre.

Kjo mbështetje e gjerë nga banorët e lagjes tregon se është koha për komunën të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të vendosë betonimin e kanalit si një prioritet për të adresuar këtë problem të rëndësishëm.

Në koordinim me këshilltarin e këshillit komunal, u dakorduam që se shpejti të përpilojmë propozim konkret në lidhje me këtë çështje dhe e njëjta të inicohet sa më shpejt në diskutimet e këshillit komunal si pikë e rendit të ditës.

QENTË E PASTREHË NË KOMUNËN E GAZI BABËS



**„Потенцијално решение
за бездомните кучиња“**

**“Zgjidhje e mundshme
për qentë e pastrehë”**

**Viktorija Smilkovska
- PLD -**



Përmbledhja

Qentë e pastrehë janë një nga problemet kryesore në komunën Gazi Babë, ku rastet e sulmeve ndaj qytetarëve janë të shumta. Viktorija e hulumtoi problemin dhe zgjidhjet e mundshme duke kryer një anketë me më shumë se 200 banorë të komunës, shumica e të cilëve (96%) janë pro ndërtimit të një strehimoreje. Ajo poashtu u takua me këshilltarët komunalë, administratën dhe palët e tjera të interesuara. Si rrjedhojë, dokumenti i politikave publike ofron zgjidhjet e mundshme për këtë problem dhe analizën kosto-përfitim për zgjidhjet e propozuara.

Komuna e Gazi Babës është komuna më e madhe për nga sipërfaqja në qytetin e Shkupit, e cila numëron 72 222 banorë. Në pajtim me të dhënat e regjistrimit të popullsisë në v. 2021, 62.6% e popullsisë janë persona nën 40 vjeç. Duke u nisur nga fakti se këta persona janë vazhdimisht në lëvizje, sa i përket shkuarjes për në shkollë, në fakultet, në vendin e punës dhe ngjashëm, ata përballen çdo ditë me probleme të shumta. Krahas mangësive infrastrukturore, qytetarët e Komunës së Gazi Babës përballen çdo ditë me problemin e qenve endacakë. Mu për këtë gjë, qytetarët të cilët e përdorin transportin publik, nuk mund të arrijnë të sigurt nga shtëpitë e tyre deri te stacioni i autobusëve⁹. Çdo ditë ballafaqohemi me ndonjë grup qensh endacakë të cilët, për shkak të kushteve të këqija dhe urisë së cilës i janë nënshtruar, reagojnë në mënyrë agresive ndaj njerëzve. Jemi dëshmitarë të rasteve të shumta të sulmit të qytetarëve nga ana e qenve endacakë. Qytetarët e Komunës së Gazi Babës, hasin në vështirësi gjatë lëvizjes së tyre në komunë, veçanërisht në orët e hershme të mëngjesit, por edhe vonë në mbrëmje. Për shkak të sulmeve që i përjetojnë, qytetarët kërkojnë dëmshpërblim nga komuna, me çka dëmtohet edhe buxheti i saj. Në vitin 2021 u ngritën 589 padi kundër Qytetit të Shkupit¹⁰. Në këtë rast Komuna harxhon mjete nga buxheti të cilat mund t'i destinojë në projekt për zgjidhjen e këtij problemi. Me fjalë të tjera, komuna kohë më parë montoi shtëpiza për qentë e pastrehë, të cilat ndërkohë nuk dhanë rezultat pozitiv. Edhe pas montimit të shtëpizave, ka pasur raste të sulmeve ndaj njerëzve¹¹. Ky problem vazhdon, si në dëm të qytetarëve, ashtu edhe të qenve që vazhdojnë të enden rrugëve, të uritur dhe të pastrehuar.

⁹ <https://kanal5.com.mk/tri-novi-sluchai-na-napadi-na-kuchinja-vrz-skopjani/a313899>

¹⁰ <https://www.dw.com/mk/%D0%B3%D1%80%D0%B0%D0%B4%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%BA%D0%BE%D0%BF%D1%98%D0%B5-%D0%B8-%D0%BE%D0%BF%D1%88%D1%82%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%81%D0%B0%D1%80%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D0%BE%D0%B4-%D1%82%D1%83%D0%B6%D0%B1%D0%B8-%D0%B8%D0%BB%D1%98%D0%B0%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B8-%D0%B5%D0%B2%D1%80%D0%B0-%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D1%9C%D0%B0%D0%B0%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D1%88%D1%82%D0%B5%D1%82%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D0%BA%D0%B0%D1%81%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BE%D0%B4-%D0%BA%D1%83%D1%87%D0%B5-%D1%81%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%BD%D0%B8%D0%BA/a-61561455>

¹¹ <https://post.mk/%D1%83%D0%BB%D0%B8%D1%87%D0%BD%D0%B8-%D0%BA%D1%83%D1%87%D0%B8%D1%9A%D0%B0-%D0%BA%D0%B0%D1%81%D0%BD%D0%B0%D0%B0-%D0%B4%D0%B2%D0%B5-%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B0-%D0%B2%D0%BE-%D0%B3%D0%B0%D0%B7%D0%B8-%D0%B1/>

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për zgjidhjen e këtij problemi janë dhënë propozim-zgjidhje të shumta. Disa prej tyre janë: sterilizimi, kastrimi, dënim për braktisjen e kafshës shtëpiake dhe ndërtimin e qendrës së trajtimit/strehimores.

Si zgjidhje më e përshtatshme është ndërtimi i qendrës për trajtimin e qenve / strehimores ku do të trajtohen qentë e pastrehë. Kjo propozim-zgjidhje është më e përshtatshme, si për qentë, ashtu edhe për qytetarët. Që ta kuptojmë qëndrimin e mirëfilltë të qytetarëve, u zbatua një anketë ku qytetarëve iu ofrua mundësia të shprehen për këtë problem. Qytetarët dhanë përgjigje në pyetjet vijuese:

- A ka në komunën tuaj qen të pastrehë?
- Sa kërcënohet jeta tuaj dhe jeta e të afërmeve tuaj nga qentë e pastrehë?
- A jeni sulmuar ju ose të afërmit e tu ndonjëherë nga të njëjtit?
- Cilat masa duhet t'i ndër marrë Komuna me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi?

Anketës iu përgjigjën 215 qytetarë të Komunës së Gazi Babës. Në pyetjen e parashtruar se cila propozim-zgjidhje për ta është më e përshtatshme 95,74% e të anketuarve deklaruan për propozim-zgjidhjen e ndërtimit të qendrës së trajtimit/strehimores.

Pas zbatimit të anketës, ideja u shkëmbye me kryetarin e Këshillit të Komunës dhe ekspertit për trajtimin e qenve të pastrehë, me ç'rast u bisedua për mundësinë e financimit të këtij projekti nga ana e komunës. Duke pasur parasysh se komuna shpenzon mjete për dëmshpërblimin e qytetarëve të sulmuar nga qentë endacakë, konkluzioni i përbashkët ishte që mjetet e njëjta mund të ridestinohen nga komuna për financimin e këtij projekti.

Me realizimin e një propozim-zgjidhje të këtillë, pra ndërtimin e qendrës së trajtimit/strehimores për qentë e pastrehë, do të zgjidhet përgjithmonë një problem madhor i qytetarëve të Komunës së Gazi Babës. Në këtë mënyrë, qytetarët e kësaj komune do të mund të qarkullojnë lirshëm dhe njëkohësisht do të shpëtohen shumë kafshë - qen të pastrehë të cilët janë të dënuar me uri dhe rrugë të ftohta.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Gostivarit

1. Mungesa e vendeve të parkimit në Komunën e Gostivarit - Admir Miftari (BDI)

2. Vendosja e e-shërbimeve në Komunën e Gostivarit – Angella Avramovska (LSDM)





MUNGESA E VENDEVE
TË PARKIMIT NË
KOMUNËN E
GOSTIVARIT

**„Нови паркинг места
во општина Гостивар“
“Parkingje të reja
në komunën e Gostivarit”**

**Admir Miftari
- BDI -**



Përmbledhja

Si shumë qytete të tjera të vendit edhe Gostivari përballlet me problemin e trafikut të ngarkuar dhe mungesës së hapësirave për parkim, veçanërisht në qendër të qytetit. Për të hetuar problemin, Admiri kreu një anketë me më shumë se 100 qytetarë dhe u takua me këshilltarët e bashkisë. Pothuajse 60% e të anketuarve ranë dakord që ndërtimi i garazheve shumëkatëshe në hapësirat ekzistuese të parkimit në qendër të qytetit.

Qyteti i Gostivarit po përballet me një problem të rëndësishëm, bllokimin e trafikut dhe mungesën e vendeve të parkimit. Qendra e qytetit, në veçanti, është prekur rëndë, me banorët dhe vizitorët që po përpiqen të gjejnë një vend për të parkuar automjetet e tyre. Kjo çështje jo vetëm që shkakton zhgënjim dhe shqetësim për ata që përpiqen të parkojnë, por gjithashtu ka një efekt valëzues në të gjithë komunitetin.

Mungesa e vendeve të parkimit në qendër të qytetit po shkakton bllokim të trafikut në rrugë pasi shoferët qarkullojnë duke kërkuar një vend për të parkuar. Kjo jo vetëm që rrit kohën e udhëtimit për individët, por gjithashtu kontribuon në ndotjen e ajrit dhe konsumimin e karburantit. Pronarët e bizneseve në qendër të qytetit janë gjithashtu të prekur, pasi vështirësia për të gjetur parkim mund të dekurajojë njerëzit të vizitojnë zonën, duke ndikuar potencialisht në fundin e biznesit të tyre.

Pavarësisht premtimeve¹² nga pushteti lokal para zgjedhjeve lokale të fundit, për të ndërtuar garazhe të reja parkimi dhe për të adresuar problemin, ende nuk kemi parë ndonjë progres. Për pesë vite, ne kemi dëgjuar të njëjtat premtime dhe nuk kemi parë asnjë veprim të ndërmarrë. Kjo mungesë veprimi, jo vetëm që është zhgënjyese, por gjithashtu po ndikon në jetën e përditshme të qytetarit.

Për hulumtim më të thellë të këtij problemi dhe për të dëgjuar zgjidhjet e mundshme nga qytetarët, një anketë¹³ me më shumë se 100 qytetarë u realizuau në fillim të 2023-shit. Bazuar në rezultatet e anketës, është e qartë se komuniteti po përballet me një problem të madh me hapësirën për parkim, në qytetin e Gostivarit. Më shumë se 95% e të anketuarve deklaruan se ka nevojë për më shumë hapësirë parkimi në qytet. Kjo tregon se situata aktuale e parkimit po shkakton shqetësim dhe zhgënjim për shumë banorë dhe vizitorë. Për më tepër, shumë të anketuar, gjegjesisht 85.9% deklaruan se kanë qenë vonë në takime, ngjarje ose në punë për shkak të vështirësive në gjetjen e parkimit.

¹² <https://www.youtube.com/watch?v=vr7zDpA6IYc>
<https://www.youtube.com/watch?v=Ap38QTjKqzs>

¹³ Anketa është realizuar gjatë periudhës janar – shkurt 2023, ku janë anketuar më shumë se 100 persona.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për të adresuar këtë çështje, është e rëndësishme që pushteti lokal të marrë masa dhe të investojë në ndërtimin e garazheve të reja të parkimit. Kjo, jo vetëm që do të ndihmojë në zbutjen e mungesës aktuale të parkimit, por edhe në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës për banorët dhe vizitorët. Për më tepër, kjo do të rrisë qasjen në qytet për të gjithë qytetarët dhe vizitorët. Duke reduktuar kohën e shpenzuar për të kërkuar parkim, banorët dhe vizitorët do të jenë në gjendje të arrijnë në kohë në takime, ngjarje dhe punë.

Një zgjidhje e mundshme që u propozua në anketë është ndërtimi i garazheve për parkim në kate. 59.2% e të anketuarve ranë dakord se ndërtimi i 3 garazheve të reja parkimi në hapësirat ekzistuese të parkimit do të ishte një mënyrë efektive për të adresuar mungesën e parkimit. 24.5% e të anketuarëve mbështesin idenë e zgjerimit të zonave aktuale të parkingjeve kurse 16.3% e të anketuarëve mbështesin idenë për ndërtimin e garazhës në kate, në një zonë aktuale parkingu.

Në diskutim me Këshilltarët komunal në Këshillin e Komunës së Gostivarit të partisë Bashkimi Demokratik për Integrim, është biseduar kjo problematikë dhe jemi në të njejtën linjë si zgjedhje të propozuara nga qytetarët. Kjo problematikë, me këto propozime për zgjidhje do të ngrihen si çështje diskutimi në seancat e radhës të Këshillit Komunal.

Ne meritojmë një qytet që është i sigurt, i aksesueshëm dhe efikas, dhe është koha që qeveria lokale të përmbushë premtimet e saj për ta bërë këtë realitet.

**VENDOSJA E E-
SHËRBIMEVE NË
KOMUNËN E
GOSTIVARIT**

E-SERVICE



**„Воведување е-услуга
во општина Гостивар“**

**“Vendosja e e-shërbimeve
në komunën e Gostivarit”**

**Angella Avramovska
- LSDM -**



Përmbledhja

Dokumenti i Anxhelës trajton problemin e qasshmërisë të qytetarëve në shërbimet komunale. Detyra themelore e dixhitalizimit të shërbimeve komunale është qasja më e lehtë dhe më e shpejtë për qytetarët. Për të përcaktuar problemin dhe për të parë zgjidhjet e mundshme, ajo kreu një anketë me më shumë se 300 qytetarë, u takua me përfaqësues të komunës, si dhe me këshilltarët e saj. Pothuajse të gjithë qytetarët dhe bashkëbiseduesit e anketuar u pajtuan se prezantimi i shërbimeve elektronike është zgjidhja më e mirë për qasje më të shpejtë dhe më efikase në shërbime, si dhe mënyrat se si mund të zbatohet.

Ideja e digjitalizimit të shërbimeve të Komunës së Gostivarit buron nga nevoja e qytetarëve për qasje në shërbimet e komunës dhe komunikim më të lehtë me personat kompetent në komunë. Tema për digjitalizimin e shërbimeve të komunave edhe pse është bërë mjaft aktuale kohët e fundit, mbetet fakti se vetëm një numër i vogël komunash në Republikën e Maqedonisë së Veriut i kanë vendosur e-shërbimet. Një nga komunat e cila ende nuk ka kaluar nëpër procesin e digjitalizimit të shërbimeve në kuadër të kompetencave të saj është edhe Komuna e Gostivarit.

Detyra themelore e digjitalizimit të shërbimeve të komunës është qasja më e lehtë dhe më e shpejtë e qytetarëve të cilët jetojnë në territorin e komunës së Gostivarit.

Rëndësia e digjitalizimit të shërbimeve të komunës vërehet nga përfitimet e digjitalizimit, e ato janë të qenit praktik dhe efikas, transparencë, përjasje, përfshirje, arritshmëri dhe automatizim i të dhënave, si dhe ulje e shpenzimeve.

Me qëllim që të kërkohet qëndrimi i qytetarëve lidhur me nevojën e e-shërbimeve të komunës dhe vallë arritshmëria e e-shërbimeve do ta zmadhojë qasjen dhe transparencën e komunës, u zbatua një hulumtim në mesin e qytetarëve të komunës së Gostivarit. Hulumtimi u zbatua përmes pyetësorit i cili u shpërnda nëpër rrjetet sociale. Rezultatet e hulumtimit vërtetuan nevojën e vendosjes së e-shërbimeve të komunës. Gjegjesisht, 93% e qytetarëve të anketuar e identifikuan mungesën e shërbimeve të arritshme onlajn si problem të madh. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve (304), 88% konsiderojnë se nëse komuna do të kishte e-shërbime të arritshme, të njëjtat do të shfrytëzoheshin nga një rreth më i gjerë qytetarësh. Një numër më i madh qytetarësh të komunës së Gostivarit, respektivisht 67,9%, kanë nevojë për e-shërbimin e arritshëm „Paraqit problem / Parashtro pyetje“, përmes të cilit drejtpërdrejtë do t'i drejtoheshin komunës, si dhe nevoja e pagesës elektronike të tatimeve dhe taksave, për çka 47,1% e të anketuarve u shprehën në favor të këtij shërbimi.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për dobinë e e-shërbimeve është e rëndësishme të njëjtat të jenë të arritshme te një numër i madh qytetarësh përmes ueb faqeve të komunave ose me anë zgjidhjes së zbatueshme dhe të njëjtat të sigurohen vazhdueshëm përmes

mënyrës së lehtë dhe të mundshme që do të mundësojë përdorimin e e-shërbimeve pa pengesa nga ana e përdoruesve përfundimtarë.

Një nga zgjidhjet e mundshme, të cilën mund komuna ta marrë përsipër, është opsioni në faqen e uebit në të cilën do të vendoset e-shërbimi. Mënyra e dytë është zgjidhja softuerike që do të jetë me një link i vendosur në faqen e komunës, që do të çojë te e-shërbimi. Zgjidhja e tretë është krijimi i një aplikacioni të veçantë në të cilën do të vendoset e-shërbimi dhe qytetarët do të kenë mundësi t'i përdorin e-shërbimet e komunës duke u kyçur me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin.

Disa rekomandime për zbatimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve të komunës i kemi shënuar si më poshtë:

- vendosja e infrastrukturës së qëndrueshme të TI-së për sigurimin e digjitalizimit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së njëjtë;
- trajnimi i të punësuarve në komunë për zotërim të suksesshëm të teknologjisë e cila do të përdoret gjatë digjitalizimit të shërbimeve;
- në rastin e komunës së Gostivarit është i rëndësishëm mundësimi i e-shërbimeve në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

Pas zbatimit të procesit të digjitalizimit dhe vendosjes së e-shërbimeve komuna do ta ketë për obligim që t'i informojë dhe t'i nxisë qytetarët për shfrytëzimin e e-shërbimeve, me qëllim të promovimit më të madh dhe përdorimit të shërbimeve digjitale nga ana e qytetarëve, përmes organizimit të fushatave, materialeve me sqarime si mund të shfrytëzohen shërbimet. Kjo nevojë e qytetarëve u identifikua edhe në takimin me përfaqësuesit e Këshillit të Komunës së Gostivarit, anëtarët e këshillit nga radhët e LSDM-së, ku u diskutua problemi i mungesës së e-shërbimeve dhe rëndësisë së nevojës së qytetarëve për digjitalizim. Nga ana e tyre u mbështet ideja për digjitalizimin e shërbimeve të komunës së Gostivarit dhe e njëjta do të ngrihet si pikë e rendin e ditës së Këshillin Komunal.

Qytetarët e komunës së Gostivarit presin se me digjitalizimin e shërbimeve të komunës do të mundësohet qasje më e lehtë dhe më e shpejtë në shërbimet e komunës, do të ngrihet niveli i arritshmërisë dhe transparencës së komunës, që janë një nga përfitimet më të mëdha të digjitalizimit.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Dolnenit

1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën e Dolnenit - Deniz Miftari (BDI)



PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË KOMUNËN E DOLLNENIT

**“Како да се подобри моменталната состојба
на патиштата во Општина Долнени?”**

**“Si të përmirësohet gjendja aktuale
e rrugëve në Komunën e Dollnenit?”**

**Deniz Miftari
- BDI -**



Përmbledhja

Denizi ka krijuar një dokument për politika publike i cili trajton mundësitë për përmirësim të infrastrukturës rrugore në komunën e Dollnenit. Denzi ka hulumtuar për këtë çështje përmes një ankete/pyetësoni me qytetarët. Ai e ka paraqitur iniciativën e tij pranë autoriteteve komunale, nga ku pritet të fillojë sa më parë kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm.

Territori i Komunës së Dollnenit shtrihet në pjesën veriore të luginës së Pellagonisë, i cili rreth 2/3 të sipërfaqes është rrafshinë dhe 1/3 është pjesë me sipërfaqe të larta kodrinore - malore duke përfshirë një sipërfaqe të përgjithshme prej 450 km². Komuna e Dollnenit është komunë rurale dhe përbëhet prej gjithsej 36 vendbanimeve, ku ka shumë pak vendbanime me nga 50 - 100 banorë, por ka edhe vendbanime të cilat numërojnë 2000 - 3000 banorë. Përbërja etnike është e natyrës së përzier ku jetojnë më shumë bashkësi etnike, prej të cilave 27% janë shqiptarë, 36% maqedonë, 19% turq, 17% boshnjakë dhe disa përqind të bashkësive më të vogla etnike (regjistrimi 2021). Komuna përbëhet prej shumë vendbanimesh dhe ka një rrjet mjaft të madh rrugësh lokale (me një gjatësi rreth 140 km infrastrukturë rrugore në nivel të Komunës) nga të cilat, jo të gjithat janë rikonstruktuar dhe rindërtuar tërësisht. Gjendja momentale e rrugëve lokale mund të thuhet se nuk është e lakmueshme, kështu që pjesa më e madhe janë asfaltuar në të kaluarën dhe tashmë janë amortizuar, disa me asfalt më të ri dhe të njëjtat janë në gjendje të mirë, por për fatkeqësisht ekziston një pjesë që aspak nuk është në gjendje të mirë dhe nuk është rikonstruktuar¹⁴. Për hulumtim më të mirë të problematikës me infrastrukturën rrugore u përpilua një pyetësor që iu dorëzua qytetarëve të komunës së Dollnenit. Prej gjithsej 104 të anketuarve, në pyetjen vallë Komuna e Dollnenit investon mjaftueshëm në infrastrukturën rrugore, 60% u përgjigjën - Po, 30% e të anketuarve - Jo dhe 10% e të anketuarve – nuk e di.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Përmirësimi i arterieve kryesore të infrastrukturës rrugore në Komunën e Dollnenit përmes asfaltimit të tyre është zgjidhje e vetme por edhe prioritet i pushtetit lokal. Megjithatë, përmes këtij dokumenti për politika publike, i cili u zhvillua me përfshirjen e qytetarëve, përmes pyetësorit të përpiluar dhe autoriteteve komunale, u përpoqëm që t'i japim përparësi projekteve të infrastrukturës rrugore.

Në pyetësor u dhanë disa opsione për rikonstruksionin e rrugëve, ku 68,7% e të anketuarve u përcaktuan që si prioritet të jetë rikonstruksioni i rrugës f. Dupjaçani - f.Desovë. Në pyetjen sipas cilit kriter u përcaktuat për rrugën

¹⁴ Bisedë me personin kompetent të sektorit urbanizëm në Komunën e Dollnenit e zhvilluar më 20 janar 2023.

konkrete, 62% e të anketuarve u përgjigjën: vjetërsia dhe domosdoshmëria e rinovimit të asaj rruge në krahasim me të tjerat, 25 % - numri i banorëve që jetojnë në ato vendbanime, 10% numri i nxënësve që udhëtojnë për në shkollë përmes kësaj rruge, 3% numri i të punësuarve që e shfrytëzojnë këtë rrugë.

Në takim me autoritetet komunale u theksua fakti se Komuna vazhdon në kuadër të mundësive të veta buxhetore dhe me ndihmën e institucioneve qendrore të RMV-së të punojë në sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për realizimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, por gjithashtu theksuan se është shumë i rëndësishëm për ta informacioni i shpalosur në këtë dokument që u jep përparësi këtyre projekteve. U diskutua që kjo iniciativë të ngrihet në Këshillin e Komunës dhe sa më shpejt të fillohet me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Për vendbanimin Dupjançani dhe fshatrat që gravitojnë përreth rrugës f. Dupjaçani – f. Desovë, rruga paraqet lidhje kryesore me selinë e Komunës së Dollnenit, përderisa për vendbanimin Desovë po ashtu paraqet lidhje kryesore me qytetin e Prilepit. Këtë rrugë e qarkullojnë përditë gjimnazistët të cilët mësojnë në qytetin e Prilepit, të punësuarit si në vetëqeverisjen vendore ashtu edhe në qytetin e Prilepit dhe shumë qytetarë të tjerë të cilët e përdorin këtë rrugë për nevoja të ndryshme. E tërë kjo tregon se sa e frekuentuar dhe e rëndësishme është kjo rrugë ndërmjet këtyre vendbanimeve dhe jo rastësisht pjesa më e madhe e të anketuarve e kanë zgjedhur pikërisht këtë rrugë si më me prioritet se sa të tjerat.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kisela Vodës

1. Vendosija e fitnes zonave në Komunën e Kisela Vodës - Gorjan Çurlinov (Partia e Vllehëve ne Maqedoni)





**VENDOSJA E FITNES
ZONAVE NË KOMUNËN E
KISELLA VODËS**

**„Поставување фитнес зони на отворено
во општина Кисела Вода“**

**"Ngritja e zonave të fitnesit në hapësira
të komunës së Kisella Vodës"**

**Gorjan Çurlinov
- Partia e Vllehëve -**



Përmbledhja

Dokumenti i Gorjanit trajton çështjen e zonave të fitnesit në natyrë, në komunën e Kisella Vodës. Në anketën online të realizuar me mbi 70 të anketuar, 95% e të anketuarve mendojnë se në komunë duhet të ketë më shumë qendra fitnesi në natyrë që do të jenë më të qasshme për të gjithë qytetarët. Për realizimin e kësaj iniciative, Gorjani ka biseduar me këshilltarët e komunës dhe ekspertët e lëmisë së sportit, të cilët kanë premtuar se do ta shtrojnë këtë çështje në këshillin e komunës.

Jemi të vetëdijshëm se pandemia e Kovid 19 në vitin 2020 na ndryshoi shumë shprehi në përmbushjen e aktiviteteve tona të përditshme, mes tjerash edhe për mënyrën si dhe ku ushtrojmë, respektivisht i kryejmë aktivitetet tona fizike. Për shkak të faktit se gjatë kohës së pandemisë, fitnes qendrat dhe palestrat ishin të mbyllura për njerëzit, nevoja për qendra të këtilla në natyrë ishte shumë e madhe. Përveç si pasojë e pandemisë, shfaqet edhe faktori socio-ekonomik ku një numër i madh i popullatës së re nuk ka mundësi të ndajë mjete për përdorimin e përditshëm dhe të rregullt të palestrave dhe/ose fitnes qendrave, të cilat janë mundësi e vetme për zhvillimin e tyre të shëndetshëm, rekreacionit të tyre dhe në masë të madhe socializimit të tyre personal.

Komuna e Kisella Vodës sipas regjistrimit të fundit të vitit 2021 numëron 61965 qytetarë, nga të cilët të moshës 15 - 29 vjeçare janë 9844 banorë dhe të moshës 30-49 vjeçare janë 17849 banorë. Në Komunën e Kisella Vodës ka tre shkolla të mesme, konvikt studentësh dhe një numër të konsiderueshëm shkollash fillore.

Momentalisht, në Komunën e Kisella Vodës janë vendosur fitnes zona në natyrë, dhe atë në lokalitetet në vijim: Parku Maqedonia, Pripor, 11 barakat, Parku Branitellët, Parku Dimo Haxhi Dimov dhe parku në birrari. Por, të gjitha lokalitetet e sipërme janë në periferinë e komunës, në vendbanimet e largëta. Në pyetësorin e anketës, zbatuar onlajn me mbi 70 të anketuar, 65% nuk i shfrytëzojnë këto fitnes qendra/zona në natyrë shkak i largësisë nga vendi i tyre i jetesës. Përndryshe, 95% e të anketuarve konsiderojnë se në komunën e Kisella Vodës duhet të ketë më tepër fitnes qendra/zona në natyrë dhe të ketë qasje të lehtë për gjithë qytetarët.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për nevojën e sipërme u bisedua edhe më këshilltarët e Këshillit komunal por edhe me profesionistë të punësuar në komunë në fushën e sportit dhe kulturës të cilët janë të kyçur drejtpërdrejt në aktivitete të këtilla. U prezantuan edhe gjetjet nga anketa, respektivisht lokalitetet ku njerëzit duan të jenë të vendosura fitnes qendrat/zonat në natyrë. Shumica e të anketuarve u shprehën se fitnes zonat e reja në natyrë duhet të vendosen në lokalitetet në vijim: vendbanimi Rasadnik, në afërsi të Konviktit studentor Pellagonia, fusha e sportit "Kisella Voda", parku "11 Tetori" dhe në oborrin e SH.E.E.J.Q.SH.,, Vasill Antevski - Dren". Në komunë theksuan se vendosja e fitnes zonës në natyrë është barë e madhe financiare për

komunën, por lokalitetet e propozuara nga ana e qytetarëve do të merren parasysh gjatë planifikimit të buxhetit të ardhshëm së komunës.

Gjithashtu, këshilltarët theksuan se do ta ngrenë këtë iniciativë në seancën e Këshillit të komunal dhe do të nxisin çështjen e vendosjes së fitnes zonave në natyrë të paktën në një nga lokalitetet e sipërpërmendura.

Si alternativë e kësaj, Komuna e Kisella Vodës kur vendos kënde lojërash për fëmijë vendos edhe disa vegla fitnesi, por megjithatë ato nuk janë të mjaftueshme.

Gjatë bisedës me profesionist, trajnues fitnesi, pozitivisht u pranua ideja për këtë iniciativë para së gjithash nga aspekti social dhe më së shumti nga aspekti shëndetësor. Ai vuri në dukje edhe pse ekzistojnë palestrat për ushtrime, shumica e banorëve nuk i shfrytëzojnë ato por parqet, edhe ai vetë që është instruktor i kësaj fushe, trajnimet i kryen po aty duke theksuar se do të ishte mirë që në çdo komunë të ketë sa më shumë parqe ku të rinjtë do të ushtrojnë dhe shoqërohen.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kriva Palankës

1. Mungesa e vendparkimeve të mjaftueshme në Kriva Pallankë - Lina Rangellova (VMRO-DPMNE)



MUNGESA E VENDPARKIMEVE TË MJAFTUESHME NË KRIVA PALLANKË



**“Зголемување на паркинг местата
преку поставување на катни гаражи“**
**“Rritja e hapësirave të parkimit nëpërmjet
vendosjes së garazheve shumëkatëshe“**



**Lina Rangellova
- VMRO-DPMNE -**



Përmbledhja

Një nga problemet më të mëdha me të cilat po ballafaqohen aktualisht banorët e komunës së Kriva Pallankës është mungesa e hapësirave për parkim. Problemi lind kryesisht për shkak të një numri të madh të qytetarëve që jetojnë në ndërtesa banimi në qendër të qytetit. Lina e hulumtoi problemin përmes një ankete, si dhe përmes takimeve me zyrtarë dhe këshilltarë të komunës. Dokumenti i saj i politikave publike ofron zgjidhje për tejkalimin e këtij problemi, nëpërmjet vendosjes së parkimit zonal (9me pagesë) ose një zgjidhje më të qëndrueshme, ndërtimin/instalimin e një garazhi shumëkatësh.

Kriva Pallanka është qytet në pjesën juglindore të vendit tonë që shtrihet në shpatet e maleve të Osogovës në të dy brigjet e Kriva Rekës. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2021, Kriva Pallanka numëron 18 059 banorë me një numër të përgjithshëm automjete pasagjerësh në komunë prej 4 103.

Një nga problemet më të mëdha me të cilat momentalisht po përballen banorët e komunës së Kriva Pallankës është mungesa e vendparkimeve të mjaftueshme. Problemi kryesisht paraqitet për shkak të numrit të madh të qytetarëve të cilët jetojnë në objekte banesore në qendrën e qytetit, ndërsa të njëjtit nuk kanë siguruar garazhe personale, vetëm për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme. Kjo rezulton me makina të parkuara në sipërfaqet publike përreth banesave, e disa prej tyre edhe në rrugët kryesore. Problemi ndërlikohet më tej nga automjetet e qytetarëve të cilët shkojnë për në punë në zonën qendrore të qytetit. Automjetet e tyre i lënë gjatë tërë ditës në këto pak vende të lira që janë në dispozicion. Si plotësim, problemi u zmadhua nga fakti që pushteti vendor e mbylli një rrugë që kalonte deri në sheshin e qytetit. Më parë, qytetarët kishin dy rrugë njëkahëshe ku mund ta ndalnin automjetin e tyre për pak kohë në rast nevoje. Por, për shkak të planit të këtillë urbanistik të autoriteteve vendore, sot ka vetëm një rrugë dykahëshe në qytet. Autoritetet vendore kanë propozime të reja madje nga më të ndryshmet për dallim nga premtimet. Miratuan vendimin me të cilin fillon procesi i vendosjes së parkimit zonal me pagesë, me të cilin vendim qytetarët për shfrytëzimin e hapësirës së parkimit në qytet do të duhet të paguajnë taksë të caktuar, shuma e së cilës paskëtaj do të përcaktohet. Me këtë gjë i rëndojnë më tej edhe ashtu buxhetet modeste të qytetarëve, në jehonën serioze të krizës ekonomike, duke mos u përqendruar ekskluzivisht në gjetjen e vendparkimeve të reja të cilat i nevojiten qytetit.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Një nga propozimet për zgjidhjen e pjesshme të problemit do të ishte vendosja e parkimit zonal, në dobi të qytetarëve rezidentë, ndërsa të tjerëve do t'u përcaktohej pagesa simbolike me kohë të kufizuar. Kjo do ta zgjidhte problemin, duke pasur parasysh se një numër i madh qytetarësh shkojnë për në punë në zonën qendrore të qytetit dhe automjetet e tyre i lënë 8 orë të tëra në ato pak vende të lira në dispozicion, duke përfituar në këtë mënyrë qytetarët rezidentë.

Megjithatë, si zgjidhje kyçe dhe afatgjate është sigurimi i vendparkimeve të reja me anë të ndërtimit të garazhit shumëkatësh. I njëjti, varësisht mundësive financiare të komunës, mund të jetë i montuar. Këto parkingje të montuara do ta shkarkojnë rrëmujën e qytetit, do t'i lirojnë qasjet në objektet afariste, në objektet e hotelarisë dhe shtëpive të bashkëqytetarëve tanë dhe do të ketë efekt plotësues me çka do t'i rikthehen këmbësorët trotuareve. Me këtë gjë do të rritet siguria e këmbësorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në trafik, do të lehtësohet qarkullimi i automjeteve dhe do të përmirësohet kultura e trafikut.

Në kuadër të projektit u zbatua një anketë në të cilën morën pjesë 456 të anketuar, nga të cilët, 58% u shprehën se parkingu zonal nuk do ta zgjidhë tërësisht problemin me parkimin në qytet, ndërsa nga ana tjetër 65% konsiderojnë se garazhi shumëkatësh do ta zgjidhë tërësisht këtë problem. U ofruan disa lokalitete, ndërsa sipas qytetarëve garazhi i montuar do të mund të vendosej në rrugën pranë Qendrës ndërkomunale për punë sociale. Në takimin e realizuar me përfaqësuesit e Grupit këshillëdhënës të VMRO-DPMNE-së u bë prezantimi i rezultateve dhe ata si këshilltarë e ndajnë mendimin e qytetarëve, mandej kjo iniciativë do të ngrihet në Këshillin komunal të Kriva Pallankës nga ana e tyre. Gjithashtu, do të duhet të shpejtohet në vënien e një korsie të tretë shtesë në rrugën kryesore. Të gjitha modelet e zgjidhjeve të lartpërmendura qofshin ato individuale apo të përbashkëta do të kontribuojnë ndjeshëm në zgjidhjen e problemit të kamotshëm të banorëve të Kriva Pallankës.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Kumanovës

1. Shfrytëzimi i bibliotekës në Komunën e Kumanovës - Vjollca Murtezi (Alternativa)

2. Infrastrukturë rrugore e papërshtatshme për personat e verbër në Komunën e Kumanovës - Julia Dimitrievska (E Majta)

3. Transportuesit e paligjshëm në Komunën e Kumanovës - Millosh Ilievski (Për Kumanovën Tonë)





SHFRYTËZIMI I
BIBLIOTEKËS NË
KOMUNËN E
KUMANOVËS

**“Да ја направиме јавната библиотека
во Куманово подостапна за младите“**

**“Та бѣјмë bibliotekën publike
në Kumanovë më të arritshme për të rinjtë ”**

**Vjollca Murtezi
- Alternativa -**



Përmbledhja

Komuna e Kumanovës ka një bibliotekë të vetme "Tane Georgievski" e cila ka një kapacitet mjaft të kufizuar të ulëseve. Poashtu biblioteka ka ritur çmimet për anëtarim dhe ka vendosur pagesë ditore. Kjo ka ndikuar në uljen e interesimit për ta shfrytëzuar hapësirën e saj. Vjollca e hulumtoi problemin në thellësi, përmes një sondazhi me studentë dhe takime me grupet e interesit. Dokumenti i saj për politikat publike ofron zgjidhje alternative për tejkalimin e sfidës përmes uljes së çmimit, si dhe përfshirjes më efektive të komunës me veprime konkrete.

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2021, komuna e Kumanovës numëron 80,953 banorë, ndërsa popullsia që ndjek arsim të mesëm, të lartë dhe studim epasdiplomike është 9,889 banorë. Me një numër kaq të madh të studentëve, rezulton nevoja për një bibliotekë të qytetit e cila përmbush nevojat e studentëve për materiale studimore, hapësira të leximores dhe me çmime të arsyeshme.

Komuna ka një bibliotekë të vetme "Tane Georgievski" e cila ndodhet në qendrën e qytetit. Udhëheqsija e bibliotekës në vitin 2022 ka sjellë vendim për një çmimore të re, e cila përveç rritjes së çmimit për regjistrim në bibliotekë, ka vendosur edhe pagesë ditore për shfrytëzimin e hapësirës së leximores. Çmimi i pagesës ditore është i 50 denarë, (në krahasim me periudhën para këtij vendimi që ka qenë pa pagesë), gjë që supozohet se ka ndikuar në uljen e numrit të studentëve për ta shfrytëzuar bibliotekën.

Nga intervista e zhvilluar me një nga nëpunësit administrativ të bibliotekës, kemi informacionet se kjo bibliotekë ka kapacitet prej maksimum 24 ulëse dhe një hapësirë shumë të vogël për ruajtjen e librave të botuar. Nga e njëjta intervistë mësohet se interesimi i studentëve në të kaluarën ka qenë jashtëzakonisht i madh, sidomos në kohë të sesionit të provimeve, kur leximorja ka qenë çdoherë e mbushur, ndërsa me vendosjen e pagesës për shfrytëzimin e leximores, interesimi ka rënë dukshëm.

Sa i përket problemit të hapësirës së pamjaftueshme, biblioteka ka paraqitur një kërkesë para 3 viteve në komunë, për ta transferuar dhe zgjeruar kapacitetin e saj, mirëpo nga komuna janë përgjigjur që nuk kanë gjetur një lokacion të përshtatshëm për të njëjtën.

Ndërkaq nga një anketë e realizuar online, me 75 studentë nga komuna e Kumanovës, në lidhje me pengesat për ta shfrytëzuar leximoren, kemi të dhëna empirike si p.sh: në lidhje me arsyet pse e shfrytëzojnë më shumë bibliotekën, 24% prej të anketuarve janë përgjigjur që e shfrytëzojnë për huazimin e librave, 24% prej tyre janë përgjigjur që e shfrytëzojnë për leximore në kohë të studimeve, 1,3% për materiale studimore, 25,3% për të gjitha arsyet më lartë dhe 25,3% janë përgjigjur që nuk e shfrytëzojnë bibliotekën. Në pyetjen se cilat janë arsyet që nuk e shfrytëzoni bibliotekën/ leximoren, përqindja më e madhe e të anketuarve, pra 46,7% janë përgjigjur që nuk e shfrytëzojnë për arsye të pagesës, 4,3% janë përgjigjur për arsye të distancës/ largësisë së vendit, 14,7% janë përgjigjur që pengesë janë kushtet (kapaciteti i vogël, zhurma etj), ndërsa 9,3 % janë përgjigjur se nuk e shfrytëzojnë për të gjitha arsyet e lartë përmendura. Në pyetjen e fundit se a do ta shfrytëzoni më shumë nëse do të

liroheni nga pagesa, 90,7% e të anketuarve janë përgjigjur me PO, ndërsa vetëm 9,3% me JO.

Kjo na lë të konludojmë se problemi kryesor në lidhje me bibliotekën e qytetit qëndron tek pagesa, ndërsa arsye të tjera të rëndësishme dhe të nevojshme janë kapaciteti dhe kushtet e bibliotekës.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Tejkalimi i përkohshëm i sfidës të spjeguar më lartë mund të arihet me **tërheqjen e pagesës për për shfrytëzimin e hapësirave të leximores**¹⁵. Zgjidhje alternative për këtë të jetë ulja e çmimit të regjistrimit nga 250 në 150 denarë, si dhe pagesa ditore për shfrytëzim të leximores të ulet nga 50 në 10 ose 15 denarë.

Në lidhje me problemin e kapacitetit të vogël të leximores, gjithashtu mund të japim disa propozime të ndryshme. E para, të transferohet biblioteka në shtëpinë e pionerëve, që është një objekt në pronësi të komunës, objekt jo funksional për vite me radhë. E dyta, përveç që duhet një objekt i ri me kushte efektive, propozohet të hapen edhe disa pika në lagje të ndryshme të qytetit, për të evituar pengesën e largësisë së bibliotekës. Për këtë ekzistojnë disa opsione si: me kërkesë të veçantë, të sigurohet pronësi nga komuna për hapësirat e ambulancës në lagjen e trimave- një objekt i shtëpisë së shëndetit i cili është plotësisht i shkatërruar dhe jashtë shfrytëzimit. Pas vendimit që ka marrë komuna që objektet e gjimnazit "Sami Frashëri" dhe shkollës së mesme të mjeksisë "Nace Bugjon" të tranferohen në hapësirat pranë kazermave, ndërtimi i të cilave pritet të fillojë këtë vit, vendi aktual i shkollave (që gjenden afër tregut të qytetit) të shfrytëzohen për bibliotekë dhe leximore.

¹⁵ Për të adresuar këtë kërkesë është realizuar takim me këshillëtarin komunal nga rradhët e Alternativës, Driton Sulejmani, (me datë 30.01.2023) i cili siguroi se do ta ngrisë çështjen në kuvendin komunal.



INFRASTRUKTURË RRUGORE E PAPËRSHTATSHME PËR PERSONAT E VERBËR NË KOMUNËN E KUMANOVËS

“Вградување на звучни сигнали во семафорите на најфреквентните локации во Куманово”

“Vendosja e sinjalistikës zanore në semaforët e rrugëve më të frekuentuara në Kumanovë”

**Julia Dimitrievska
- E Majta -**



Përmbledhja

Dokumenti i Julias për politika publike trajton problemin e infrastrukturës së dobët të trafikut në Kumanovë, e cila krijon vështirësi për personat e verbër. Ajo pati takime me përfaqësues të shoqatave për persona me nevoja të veçanta dhe me përfaqësues nga komuna. Zgjidhjet e propozuara do të prezantohen dhe diskutohen në mbledhjet në vijim të këshillit të komunës, kompetencë e të ciliës është trafiku në nivel të qytetit.

Qyteti i Kumanovës ka një popullatë prej 75 000 banorësh. Sipas evidencës së shoqatës „Inkluziva” dhe shoqatës „Personat që janë të verbër” në Kumanovë, numri i personave të verbër është 110. Të njëjtit paraqesin një kategori të cenueshme, të cilës duhet t’i kushtohet kujdes më të madh. Që këtë rrjedh nevoja thelbësore për një qasje më serioze ndaj këtyre çështjeve.

Vëllimi i problemeve me të cilat këta persona ditë për ditë përballen është i madh, por problem më i madh është kërcënimi i sigurisë gjatë qarkullimit të tyre në qytet. Shtrirja e kësaj sfide vjen duke u zgjeruar në rast se kësaj kategorie të personave të verbër ia shtojmë edhe kategorinë e personave me shikim të dobësuar.

“Mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme rrugore në qytet, duke filluar nga rrugët e gërmuara, mungesa e shtigjeve të shënuara, mungesa e sinjalizimit përkatës rrugor në udhëkryqe dhe në mjetet e posaçme të transportit, paraqet rrezik për sigurinë dhe kërcënim për jetën gjatë lëvizjes së personave të verbër apo që kanë shikim të dobësuar” – deklaroi përfaqësuesja e shoqatës “Inkluziva”.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Lidhur me problemet e lartpërmendura, për qarkullimin e lirshëm dhe të sigurt të personave që janë të verbër, ka disa alternativa:

- vendosja e një shtegu të përshtatshëm për qarkullim me drejtime në trotualet për personat e verbër dhe me shikim të dëmtuar,
- instalimi i sinjaleve zanore në semaforët,
- platformat speciale në autobusë dhe ngjashëm.

Megjithatë, duke pasur parasysh mundësitë financiare të komunës dhe realizueshmërinë e propozim-masave të lartpërmendura, palët përkatëse konsiderojnë se do të duhej të fillohej me instalimin e sinjaleve zanore në semaforët në vendet më të frekuentuara dhe atë në semaforin i cili ndodhet në udhëkryqin te Bulevardi “Brigada e Tretë Sulmuese Maqedone”, përballë tregut të qytetit. Semafori i këtij udhëkryqi paraqet një nga vendet më të frekuentuara, për shkak të faktit se në këtë pjesë ndodhet tregu që vizitohet ditë për ditë nga ana e personave të verbër ose me shikim të dobësuar dhe ndodhet në qendrën e qytetit. Gjithashtu, në këtë pjesë ndodhen shkollat dhe kafenetë ku personat e

verbër dhe me shikim të dobësuar e shfrytëzojnë kohën për pushim dhe rekreacion.

Nga konsultimi i bërë me përfaqësues të Komunës së Kumanovës kompetencë e të cilëve është trafiku rrugor në nivel qyteti, u morën informacione rreth lartësisë së mjeteve financiare të nevojshme për instalimin e të ashtuquajturit moduli me sinjal zanor në semaforët. Lartësia e këtyre mjeteve varion prej 100 deri në 130 euro”.

Edhe pse nuk është e mundur për një periudhë të shkurtër të shqyrtohen dhe të zgjidhen të gjitha problemet e personave që janë të verbër dhe me shikim të dobësuar, qasja në zgjidhjen e problemit të përmendur, do të jetë një shtysë dhe motiv i mirë për këtë kategori personash për t’i marrë të drejtat dhe mundësitë e veta. Problemi do të diskutohet në nivel partiak dhe më vonë me shumë mundësi do të shpaloset para Këshillit të qytetit të Kumanovës. Me këtë Kumanova do të bëhet një vend më i mirë për të jetuar, sidomos për këta persona, ndërsa mënyra se si qyteti i qaset çështjes së ballafaqimit të këtyre problemeve, do të jetë një shembull i shkëlqyeshëm për qytetet tjera të vendit tonë.

TRANSPORTUESIT E PALIGJSHËM NË KOMUNËN E KUMANOVËS



**“Лиценцирање на таксисти
без соодветна дозвола за превоз“**

**"Licencimi i taksistëve
pa leje të rregullt transporti"**

**Milosh Ilievski
- Për Kumanovën Tonë -**



Përmbledhja

Dokumenti i politikave publike të Milloshit trajton problemin e taksistëve ilegalë në Kumanovë. Në kuadër të angazhimit të tij me komunitetin, ai bisedoi me aktorë të ndryshëm për këtë problem: transportuesit ilegal, shërbimet e inspektimit, komunën dhe qytetarët. Si zgjidhje më e përshtatshme për këtë problem, dokumenti ofron përfshirjen e vetëqeverisjes lokale duke ofruar ndihmë të caktuar financiare (subvencione) për licencimin e transportuesve ilegal.

Komuna e Kumanovës është njëra nga komunat më të mëdha në vend me mbi 100.000 banorë, në të cilën sot ka 37.000 automjete të regjistruara dhe e njëjta përballet me problemin e taksistëve pa licencë pune dhe të transportuesve tashmë disa vite me radhë. Në qytet ekzistojnë 60 taksistë të licencuar, ndërsa numri i atyre që ushtrojnë veprimtarinë e transportit me taksi pa lejë/licencë përkatëse është i madh. Ekzistojnë disa arsye për shkak të cilave transportuesit nuk marrin licencë. Njëra nga arsyet është mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare për të paguar taksat e nevojshme për marrjen e licencës, në ç`mënyrë, duke iu shmangur dispozitave ligjore, i shmangen edhe pagesës së taksave. Po ashtu, sipas legjislacionit¹⁶, në qoftë licencohen, automjeti përkatës i bartet subjektit juridik, ku gjobat me para janë dukshëm më të mëdha, në krahasim me rastet kur nuk janë të licencuara dhe kur automjeti është në pronësi personale. Në këto vite të fundit, problemi më i madh është që Kumanova si komunë e dytë më e madhe ka vetëm një inspektor për komunikacion rrugor dhe kjo nuk është e mjaftueshme për t`ia dalë në krye transportuesve të palicencuar.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për t`ia dalë në krye me rrjetin e transportuesve individualë të palicencuar të cilët funksionojnë jashtë kornizës ligjore, po i propozojmë këto modele zgjidhjesh:

- përfshirjen e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet dhënies së ndihmës së caktuar financiare (subvencioneve) për mbulimin e gjysmës së shpenzimeve të nevojshme për marrjen e licencës;
- rritjen e numrit të inspektorëve për komunikacion rrugor, me qëllim që të mundësohet kontrolli i shtuar i auto-taksive të palicencuara dhe të pasigurta, që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve.
- të ngrihet vetëdija e të gjithë transportuesve të palicencuar në lidhje me pajisjen e licencës dhe regjistrimin si subjekt juridik, por edhe t`u sqarohen përfitimet që takojnë me pajisjen e kësaj licence transporti.

¹⁶ Ligji për transportin rrugor (Gaz.zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 68/04 dhe 275/19)

Në bisedë me palë të ndryshme të prekura nga ky problem, respektivisht intervistat me tre transportues të palicencuar të moshës 50 vjeçare, shërbimet inspektoriale, dy përfaqësues të administratës komunale dhe me këshilltarë dhe me një grup qytetarësh si zgjidhje më e përshtatshme e këtij problemi theksohet përfshirja e vetëqeverisjes lokale përmes dhënies së ndihmës së caktuar financiare (subvencioneve) për licencimin e transportuesve të paligjshëm.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Likovës

1. Deponitë e egra në Komunën e Likovës - Herolinda Ramadani (Aleanca për Shqiptarët)





DEPONITË E EGRA NË KOMUNËN E LIKOVËS

**„Решение за дивите депонии
во општина Липково“**

**“Zgjidhje për deponitë e egra
në Komunën e Likovës”**

**Herolinda Ramadani
- Aleanca për Shqiptarët -**



Përmbledhja

Me vite të tëra Komuna e Likovës përballet me problemin e deponive të egra, pa marë parasysh premtimet e përsëritura të autoriteteve për zgjidhjet e mundshme. Për këtë arsye, Herolinda vendosi ta hulumtojë këtë problem dhe të mundohet ta ofrojë zgjidhjen më të mirë. Ajo kreu një sondazh me 50 qytetarë, ku 88% u përgjigjën se janë të vetëdijshëm për ekzistencën e deponive dhe 76.5% mendojnë se fajtor për krijimin e këtyre deponive është Komuna, kurse 17.6% mendojnë se janë bizneset lokale dhe pjesa tjetër mendojnë se janë qytetarët. Në takim me disa këshilltarë komunalë u premtua se problemi i deponive dhe rezultatet e sondazhit do vihen në rend dite të këshillit dhe do kërkohet zgjidhja e mundshme për këtë problem.

Me vite të tëra Komuna e Likovës përballet me problemin e deponive të egra, mirëpo asnjëherë nuk është bërë ndonjë veprim për zgjidhjen e këtij problemi të kahmotshëm. Edhe pse është premtuar shumë vite, qytetarët e kanë humbur besimin për zgjidhjen e këtij problemi.

Në lidhje me kontrollin e deponiveve, përgjegjësia është e ndërmarrjes publike komunale "Pisha". Megjithatë, perceptimi i qytetarëve është se kjo ndërmarrje nuk ka arritur ndonjë rezultat të dukshëm në këtë drejtim përkundër mbështetjes nga buxheti komunal.

Banorët e fshatit Negushtak dhe Orllancë kanë bërë nismë të rëndësishme për rilokimin e deponive të dëmshme. Megjithatë, edhe pse ata kanë qenë vokal dhe kanë bërë fushatë aktive, kërkesat e tyre nuk kanë rezultuar me ndonjë reagim nga personat përgjegjës.

"Deponitë e egra në këto komuna janë "bombë" e vërtetë mjedisore. Këtu mund të gjeni pothuajse gjithçka, nga mbeturinat ndërtimore, shishe plastike dhe qelqi, lodra të panevojshme dhe madje edhe mbetje ushqimore. Është e frikshme që këto deponi shpesh digjen, ndërsa tymi është i keq për shëndetin e banorëve përreth".

"Problemi është te komuna, ne pastrojmë mbeturinat në fshat. Që nga viti i ri vetëm katër herë i kanë mbledhur mbeturinat nga fshati. I djegin mbeturinat."

"Nuk mund të flemë për shkak të erës së keqe. Shtëpia ime është dhjetë metra larg deponisë. I gjithë fshati vuan nga mbeturinat, nuk ka qenë kurrë kështu. A kemi komunë ose jo, më duket se nuk kemi", janë vetëm disa nga reagimet e qytetarëve.

Në një sondazh online të zhvilluar me 50 qytetarë, 88% prej tyre janë shprehur se janë të vetëdijshëm për ekzistencën e deponive të egra. 76.5% e qytetarë mendojnë se fajtor për krijimin e këtyre deponive është Komuna, 17.6% mendojnë se janë bizneset lokale dhe pjesa tjetër mendojnë se janë qytetarët..

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Nëpërmjet konsultimeve dhe sondazheve të zhvilluara me komunitetin vendas, u nxorën disa rekomandime për zgjidhjen e problemit të hedhjes së paligjshme të mbeturinave.

Shumica e qytetarëve kanë shprehur nevojën e një ndërgjegje kolektive për këto deponi dhe kanë kërkuar veprime të menjëhershme për të ruajtur një mjedis jetësor të shëndetshëm. Autoritetet kompetente duhet të jenë të shpejta në përpjekjet e tyre për të adresuar këtë problem.

Mirëpo, edhe gjatë anketës, qytetarët u pyetën se cilat mund të jenë zgjidhjet e mundëshme për këtë problematikë. Mbi 70% e qytetarëve janë deklaruar për këto opsione:

1. Pastrimi i rregullt i deponive të egra nga ana e ndërmarrjes komunale;
2. Kampanjë për vetëdijësimin e qytetarëve;
3. Inspektime më të shpeshta dhe vendosja e gjobave të larta nga ana e inspektoratit komunal;
4. Përmirësimi i shërbimeve të ndërmarrjes komunale "Pisha" në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Likovës.

Në konsultim me këshilltarët e Aleancës për shqiptarët, të cilët gjithashtu konfirmuan shqetsimet e qytetarëve për këtë temë, u konkludua që këtë problematikë dhe propozim zgjidhjet të vëndosen si pika të rendit të ditës në seancat vijuese të Këshillit Komunal dhe të diskutohet për zgjidhje sa më të shpejtë.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Makedonski Brodit

1. Vendosja e E-shërbimeve në Makedonski Brod - Sonja Jovanovska (PLD)



VENDOSJA E E- SHËRBIMEVE NË MAKEDONSKI BROD



**„Воведување е-услуги
во Македонски Брод“**

**"Vendosja e e-shërbimeve
në Makedonski Brod"**

**Sonja Jovanovska
- PLD -**



Përmbledhja

Ky dokument trajton problemin e vendosjes së e-shërbimeve në komunën e Makedonski Brodit. Për të identifikuar këtë nevojë dhe zgjidhjen e mundshme, Sonja ka bërë një anketë mes qytetarëve, ku pothuajse të gjithë i janë përgjigjur pozitivisht nevojës për futjen e shërbimeve elektronike. Për realizimin e kësaj iniciative, ajo u takua me përfaqësues të komunës, përkatësisht me kryetarin e komunës, një zyrtar ligjor dhe një këshilltar, të cilët premtuan se do të ndër marrin hapat e nevojshëm për futjen e shërbimeve elektronike në komunë.

Një numër i vogël njësish të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut i kanë vendosur e-shërbimet, ndërsa njëra prej tyre është edhe Komuna e Makedonski Brodit, e cila kohët e fundit po ngec në procesin e digjitalizimit të shërbimeve. Teknologjia digjitale është një nga mjetet më të rëndësishme për vendosjen e urës ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Po ashtu, një ndër përfitimet për qytetarët nga përdorimi i shërbimeve elektronike është ajo që qytetarët nuk do të presin në sportel dhe do të mund të kursejnë kohë dhe të mbarojnë punë më shpejt onlajn.

Makedonski Brodi është njëra nga komunat më të vogla në Republikën e Maqedonisë së Veriut me numër të përgjithshëm banorësh prej 7.141, me 51 vendbanime, sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2021.

Me ueb faqen e re, komuna është më e hapur/transparente për qytetarët, por problemi kryesor me të cilin momentalisht po përballen banorët e Komunës së Makedonski Brodit është digjitalizimi i komunës i cili është më se është i nevojshëm, veçanërisht për qytetarët e vendbanimeve larg qytetit.

Për t'u marrë parasysh edhe mendimi i qytetarëve në Komunën e Makedonski Brodit, u zbatua një sondazh nëpërmjet pyetësorit në formën online, i cili u shpërnda përmes rrjeteve sociale.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, gjithsej 43, 100% është vënë në dukje nevoja e vendosjes së e-shërbimeve në komunë, të cilët e identifikojnë si problem mungesën e qasjes në shërbimet onlajn. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 97.7% konsiderojnë se, në qoftë se komuna do të kishte e-shërbime të arritshme, të njëjtat do të përdorëshin nga një rreth më i gjerë qytetarësh.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Problemi u diskutua edhe me përfaqësuesit e komunës, nëpunësin për çështje juridike në komunë, një nga këshilltarët dhe me kryetarin e komunës, të cilët pajtohen se nevoja e futjes së shërbimeve digjitale paraqet një sfidë, në të cilën në të ardhmen do të përqendrohen më shumë.

Në bisedë me palët e sipërme të interesuara u propozuan modelet e zgjidhjes së mëposhtme të këtij problemi:

- Futja e e-shërbimeve në ueb faqen e komunës;
- Zgjidhja softuerike për vendosjen e-shërbimeve;

- Aplikacioni celular për e-shërbimet e komunës.

Po ashtu, nga rezultatet e anketës, qytetarët konsiderojnë se komuna duhet t'ua ofrojë të paktën këto shërbime onlajn:

- Paraqit problem/parashtro pyetje - 63% e të anketuarve;
- Pagesa e faturave/tatimeve - 53,5% e të anketuarve;
- Lajmërohu për.../Merr pjesë në - 39,5% e të anketuarve.

Me këshilltarët e pavarur, por edhe me këshilltarët e partive të tjera politike në Këshillin e Komunës së Makedonski Brodit u bisedua, njëkohësisht u mor vendim, që kjo problematikë të vihet në rendin e ditës në njërën nga seancat e ardhshme të këshillit komunal dhe të propozohen zgjidhjet e lartpërmendura pranë këtij këshilli, kryetarit të komunës dhe shërbimeve administrative të komunës.

Ofrimi i e-shërbimeve domethënë transparencë më e madhe dhe vendosje e zgjidhjeve praktike me të cilat lehtësohet jeta e përditshme e qytetarëve dhe çka është më e rëndësishme, pasi këto zgjidhje do të mundësohen dhe do të integrohen, nevojitet qëndrueshmëria e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Prilepit

1. Mbrojtja nga dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Komunën e Prilepi - Natali Kitanovska (LSDM)

2. Komuna e Prilepit me Qendër Rinore - Hristijan Tuneski (VMRO-DPMNE)



MBROJTJA NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRILEPI



**“Непријавување насилство врз жени
и девојчиња со попреченост“**

**"Mos raportimi i dhunës ndaj grave
dhe vajzaveme aftësi të kufizuara"**

**Natali Kitanovska
- LSDM -**



Përmbledhja

Në dokumentin e saj për politika publike, Natalia e trajton çështjen e mosraportimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Ajo e ka hulumtuar problemin përmes intervistave me persona me aftësi të kufizuara në territorin e komunës së Prilepit dhe punonjës të qendrave për punë sociale në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dokumenti ofron edhe disa zgjidhje për problemin, siç janë: trajnime për stafin që punon me gratë me aftësi të kufizuara në qendrat për personat me aftësi të kufizuara, realizimi i fushatave edukative për ndërgjegjësime, etj.

Të dhënat e Qendrës për punë sociale në Komunën e Prilepit tregojnë se numri i rasteve të raportuara të dhunës familjare ka shënuar rritje (për v. 2014-50 lëndë; v. 2015-142 lëndë; v. 2016-162 lëndë) që tregon një vetëdijesim të madh dhe besim në institucionet. Për fat të keq, kjo dukuri nuk bën rast kur bëhet fjalë për dhunën ndaj grave dhe vajzave të vogla me aftësi të kufizuara. Kjo kategori e banorëve dhe banoreve të Komunës së Prilepit nuk i denoncon këto raste në Qendrën për punë sociale dhe kështu mungon reagimi institucional në kohë për zbatimin e masave parandaluese.

Me qëllim të konstatimit të situatës reale dhe të hulumtimit më të thellë, në terren u zbatuan anketa me të punësuarit e QPS-së edhe me gratë me aftësi të kufizuara. Sipas grave me aftësi të kufizuara më së shpeshti ndodh dhuna fizike, psikike, seksuale, dhuna ekonomike dhe gjuha e urrejtjes. Ato veten e identifikojnë si gra të cilat varen nga familja apo partneri i vet dhe bëjnë të ditur se shpeshherë përballen me dhunën, por nuk kanë informacione të mjaftueshme se si ta raportojnë të njëjtën ose më së shpeshti kur e kanë bërë këtë thonë se nuk kanë marrë përgjigje adekuate ose janë përballur me protokolle që nuk i përgjigjen situatës së tyre. Ato bënë të ditur gjithashtu se nuk janë të përfshira në mënyrë të barabartë në strukturat që krijojnë politikën, dhe, prandaj, shpesh herë nevojat e tyre për këtë çështje anashkalohe. Edhe pse me Ligjin e ri për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, institucionet obligohen në dhënien e përgjigjes adekuate dhe me kohë, megjithatë gratë me aftësi të kufizuara ndodhen jashtë grupit të grave të cilat bëjnë denoncimin e dhunës. Sipas anketave me të punësuar në QPS, në vitin 2021 ka vetëm pesë raportime të dhunës familjare të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa vitin e fundit numri i denoncimeve është zvogëluar në mbarë territorin e shtetit. Ky nuk është tregues se dhuna nuk po ndodh, por është tregues se gratë nuk trimërohen që ta raportojnë të njëjtën. Sipas regjistrimit të fundit (v.2021) në territorin e Komunës së Prilepit u evidentuan 2 886 gra me aftësi të kufizuara ndërsa qendra për punë sociale asnjë dhunë ndaj këtyre grave nuk e ka evidentuar vitin e kaluar (v. 2022). Me qëllim të hetimit të situatës reale në komunë u realizua një intervistë me këshilltarin e Komunës së Prilepit dhe u bisedua me të lidhur me atë se a ka plan komuna për ngritjen e vetëdijes lidhur me raportimin e dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara, por hasi në përgjigje negative. Sipas këshilltarit çështja e këtillë asnjëherë nuk ka qenë temë në asnjë nga mbledhjet e këshillit të komunës.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Vetëdijesim më të madh për raportimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave të vogla me aftësi të kufizuara, qëllimi është që dhuna të parandalohet, të pengohet si dhe të mbrohen viktimat nga viktimizimi dytësor brenda ose jashtë familjes së tyre. Pas intervistës me këshilltarin e vetëqeverisjes lokale të Komunës së Prilepit, me të punësuarit në QPS si dhe me personat me aftësi të kufizuara, është bërë e ditur se për këtë kategori të banorëve/banoreve të Komunës së Prilepit nuk ekziston udhëzimi apo edukimi i duhur se si të raportohet dhuna, por edhe si të dallohet ajo.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes kundër dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara është e nevojshme të zhvillohen trajnime lidhur me ndjeshmërinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave të vogla në disa nën grupe. Para së gjithash duhet edukim dhe ndërgjegjësim për vetë personat, pastaj edhe për personelin që punon me ta qoftë në kushte shtëpiake, qoftë në institucione të caktuara. Është i duhur edukimi dhe ndërgjegjësimi edhe për personelin mjekësor sepse më shpesh janë këta njerëz të cilët hyjnë në kontakt me këta persona.

Si për fillim, qasja më e përshtatshme do të ishte edukimi dhe ndërgjegjësimi, që mund të realizohet nëpërmjet fushatës edukative për parandalimin e dhunës. Rol të rëndësishëm do të kishin edhe trajnimet në shkollat fillore dhe të mesme nga ana e profesionistëve lidhur me këtë çështje, për shkak se fëmijët shpesh janë dëshmitarë të këtyre akteve dhe mbeten raste të pavërejtura ose të fshehura, që asnjëherë nuk arrijnë tek shërbimet profesionale.

Këto propozime iu bënë të njohura këshilltarit të Komunës së Prilepit.



KOMUNA E PRILEPIT
ME QENDËR RINORE

„Прилеп со младински центар“

"Prilepi me qendër rinore"

**Hristijan Tuneski
- VMRO-DPMNE -**



Përmbledhja

Ky dokument i politikave publike trajton çështjen e Qendrës Rinore në Prilep. Pas disa takimeve me palët e interesuara, përmes kërkesës për qasje në informacionin publik, Hristiani siguroi një listë të objekteve nën juridiksionin e komunës që janë të përshtatshme për qendër rinore. Në bashkëpunim me zyrtarin për rini në komunë, është rënë dakord që themelimi i Qendrës Rinore të trajtohet si prioritet.

Në territorin e Komunës së Prilepit sipas regjistrimit të vitit 2021 janë regjistruar 69.025 banorë. Prej tyre 11.452 (16.6%) janë të rinj të moshës prej 15 deri në 29 vjeç. Nga ky numër 5.885 të rinj ose 51.4% janë pjesëtarë të gjinisë mashkullore, ndërsa 5.567 ose 48.6% janë pjesëtare të gjinisë femërore.

Problem i përgjithshëm në Komunën e Prilepit, si dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut është shpërngulja e të rinjve gjatë viteve të fundit, në kërkim të standardit më të mirë të jetesës, pagave më të mira dhe cilësisë së lartë të jetës.

Nëse flasim në mënyrë të përgjithshme për këtë problem, do të përfundojmë se për të kontribuojnë shumë faktorë. Por, tani parashtrohet pyetja: „Ç`mund të bëjmë ne që t`i mbajmë në vendin tonë të rinjtë të cilët ende jetojnë këtu“? dhe, në të njëjtën kohë, të propozohen zgjidhjet pozitive. Komuna e Prilepit, ka mungesë të vendeve ku të rinjtë do të shoqëroheshin, argëtoheshin dhe edukoheshin në formën e Qendrës rinore.

Me Ligjin për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore i miratuar në 14 janar të vitit 2020, çdo komunë obligohet të themelojë Këshill rinor në kuadër të së njëjtës, ndërsa ky Këshill rinor duhet të funksionojë në bazë të parimit të Këshillit të Komunës¹⁷.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Themelimi i një Qendre rinore të këtillë sigurisht do të kontribuojë në bashkëveprimin e të rinjve në Prilep dhe në zvogëlimin e „pasivitetit“ në segmentet e caktuara të jetës. Ka disa mënyra për themelimin e këtij institucioni, ndërsa njëra prej tyre është si më poshtë: Themelimi i Qendrës rinore nëpërmjet themeluesit i cili mund të jetë Këshilli rinor lokal i komunës.

Ky opsion është shqyrtuar edhe në takimin me zyrtarin komunal për të rinj pranë Komunës së Prilepit, e cila do të kontribuojë në procesin që tashmë ka filluar për zgjedhjen e përbërjes së re të këshillit rinor lokal. Gjithashtu u realizua një takim me këshillin nismëtar (me përbërje të anëtarëve të disa organizatave rinore të cilat gravitojnë në territorin e Komunës së Prilepit) për themelimin e asamblesë rinore e cila më vonë do të jetë themeluese e Këshillit rinor përfundimtar.

¹⁷ Ligji për pjesëmarrje rinore, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2020/03/Zakon-za-mladinsko-uchestvo-i-mladinski-politiki-16-01-2020.pdf>

Nëpërmjet kërkesës për qasje në informacione me karakter publik, Komuna dërgoi listën e objekteve të lira të cilat janë në kompetencë të Komunës, dhe të njëjtat mund të përshtaten për Qendrën rinore. Lokalitetet e lira të cilat i përgjigjen nevojave të qendrës iu kumtuan zyrtarit komunal për të rinjtë dhe në atë takim u vendos që pas themelimit të Këshillit rinor lokal (pritet të jetë muaji prill) t'i jepet përparësi Qendrës rinore. Me anë të pjesëmarrjes së Forumit të komunitetit, në organizim të UNDP-së, u propozua që një nga aktivitetet të jetë rikonstruksioni dhe pajisja e objektit ekzistues për nevojat e qendrës rinore.

Zgjidhja e propozuar është e përshtatshme dhe e realizueshme për themelimin e Qendrës rinore e cila më vonë do të funksionojë në interes të rinisë dhe do ofrojë diçka që nuk e ka pasur deri më tani qyteti i Prilepit.


Angazhimet e komunitetit në Komunën e Radovishit

1. E-shërbimet në Komunën e Radovishit - Maja Uzhevaska (LSDM)

2. Si të ringjallet kultura e kinemasë në Radovish!? - Marija Kërsteva (LSDM)



E-SHËRBIMET NË KOMUNËN E RADOVISHIT



**“Воведување е-услуги
во општина Радовиш”**

**“Vendosja e e-shërbimeve
në komunën e Radovishit”**

**Maja Uzhevskaja
- LSDM -**



Përmbledhja

Dokumenti i Majës trajton problemin e qasjes të qytetarëve në shërbimet komunale. Detyra themelore e dixhitalizimit të shërbimeve komunale është qasja më e lehtë dhe më e shpejtë për qytetarët. Për të hulumtuar problemin dhe për të parë zgjidhjet e mundshme, Maja bëri një sondazh me rreth 80 qytetarë, prej të cilëve mbi 90% janë përgjigjur se komuna ka nevojë për futjen e shërbimeve elektronike. Pothuajse të gjithë qytetarët e anketuar ranë dakord se dixhitalizimi është zgjidhja më e mirë dhe ofron qasje më të shpejtë dhe më efikase në shërbime. Shërbimet më të kërkuara janë pagesa e faturave, raportimi i një problemi dhe parashtrimi i pyetjeve.

Komuna e Radovishit është një njësi relativisht e vogël administrative e cila i kënaq nevojat e pothuaj se 28.000 banorëve. Brenda kufirit të saj territorial, ekzistojnë disa probleme të cilat me vite ndodhen në agjendat e garniturave të shumta të pushtetit lokal. Një nga problemet konkrete me të cilat përballen qytetarët e Komunës së Radovishit është mungesa e digjitalizimit të plotë të shërbimeve që i ofron komuna. Çdo gjë që ofrohet si shërbim prej njësisë së vetëqeverisjes lokale në formë letre imponohet tashmë si domosdoshmëri, edhe pse ekziston opsioni të merret në formë elektronike. Procedura e digjitalizimit ka filluar për disa lloje shërbimesh, ndërsa për disa të tjera, tashmë ka përfunduar, megjithatë qytetarët nuk kanë njohuri për këto mundësi.

Me fjalë të tjera, në ueb faqen përkatëse ka një fushë ku qytetarët mund t'i parashirojnë pyetje onlajn kryetarit të komunës, një risi e vënë në mandatin aktual të kryetarit të komunës. Po ashtu, në ueb faqen e njëjtë, në fushën për shërbime, në menynë e poshtme janë dhënë disa opsione mes tjerash edhe e-shërbimet dhe e-pëlqimi për ndërtim.

Te e-shërbimet, janë ofruar më tepër lloje shërbimesh të cilat, realisht, përfshijnë një gamë të gjerë shumëllojshmërie, megjithatë janë lënë shërbimet e thjeshta, ndërsa mjaft të rëndësishme. Në këto lloje shërbimesh përfshihen: vendim për tatimin prone, vendim për tatim trashëgimie dhe dhuratë, vendim për tatim qarkullimi të pasurive ta paluajtshme, vendim për kthimin e shumës së borxhit të paguar gabimisht/më tepër seç duhet, vendim për taksë komunale për emërtimin e kompanisë, taksë komunale për përdorimin e muzikës, shfaqjen e reklamave dhe shpalljeve, kërkesë për vërtetimin e tatimit të paguar të pronës, lejë për vendosjen e linjave telefonike, telegrafike, kablllove dhe të tjera, kërkesë për vërtetimin legal të lejes së miratuar për ndërtim, kërkesë për vërtetimin e objektit ndihmës, serrës ose objektit për përpunim primar; kërkesë për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të RMV-së, kërkesë për dhënien e vërtetimit për parcelë kadastrë, njoftim për objekt të përfunduar, etj.

Për hulumtimin më në detaje të këtij problemi, u zbatua një anketë prej disa pyetjesh në të cilën u përgjigjën 78 të anketuar – banorë të komunës së Radovishit. Të anketuarit, ndajnë mendimin se Komuna e Radovishit ka nevojë për digjitalizim. Më shumë nevojë kanë për mënyrën elektronike të pagesës së faturave, ndërsa me këtë gjë konsiderohet se do të zmadhohet transparenca e komunës dhe nëse kjo do t'u bëhej e mundur të njëjtit do t'i shfrytëzonin ato e-shërbime. Në bisedë me Koordinatorin e grupit këshillëdhënës së LSDM-së, u cek se ky problem s'është vënë fare në rendin e ditës deri tash.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Sipas anketës së zbatuar, komuna e Radovishit ka nevojë të madhe për digjitalizimin e shërbimeve plotësuese, ndërsa këtë e vërtetojnë 92.1% e të anketuarve. Kërkesa më të mëdha ka për shërbimet „Pagesa e faturave“ dhe „Paraqit problem/ parashtro pyetje“.

Për të zgjidhur këtë problem, janë të mundshme disa zgjidhje alternative, ndër të cilat:

- Zhvillimi i një platforme të veçantë faturimi;
- Të ndërrohet ueb faqja ekzistuese me shërbime shtesë;
- Të bëhet i detyrueshëm identiteti elektronik dhe çdo qytetar të ketë qasje në të gjitha e-shërbimet.

Masa me të cilën më se shpejti do të arrihet qëllimi është që të ndërrohet ueb faqja ekzistuese dhe të shtohen shërbimet plotësuese. Në këtë çast kjo është zgjidhja më efikase, në përgjithësi, dhe nga ana ekonomike, në veçanti, sepse do të avancohej softueri i tanishëm dhe mbi këtë bazë do të bëheshin plotësime tjera.

Nga një këndvështrim tjetër, e gjithë kjo do të lidhej me Drejtorinë e të Hyrave Publike, në pjesën e tatimeve, ndërsa me institucionet e veçanta administrative, në pjesën e taksave dhe faturave. Kjo do të nxiste hapjen e vendeve plotësuese të punës, të cilët do të punonin në dhënien e shërbimeve onlajn, krahas shërbimeve të rregullta dhe tradicionale në formën fizike. Sipas praktikës së vazhdueshme të buxhetit, me rebalancin e buxhetit dhe futjen e kësaj zgjidhjeje në pjesën e shpenzimeve, do të mundësohej realizimi i saj.

Të gjithë të anketuarit u shprehën pozitivisht ndaj këtij ndryshimi, me çka zgjidhja e problemit me digjitalizimin e plotë në Komunën e Radovishit do të kishte të mira të përbashkëta. Efekti do të ishte transparenca më e madhe e komunës, kursimi i kohës, bashkëpunimi efektiv dhe efikas ndërmjet qytetarëve dhe komunës.

SI TË RINGJALLET KULTURA E KINEMASË NË RADOVISH!?



**“Како да се оживее
кино-културата во Радовиш?”**

**"Si të ringjallet kultura
e kinemasë në Radovish?"**

**Marija Kërsteva
- LSDM -**



Përmbledhja

Në dokumentin për politikë publike, Maria trajton problemin e kinemasë së qytetit, pra teknologjinë e vjetëruar për projeksion të filmave. Me përmirësimin e kushteve të kinemasë, synohet përmirësimi i jetës së përgjithshme kulturore në Radovish. Lidhur me këtë problem, Maria u takua me këshilltarë dhe përfaqësues të komunës, të cilët do të paraqesin kërkesë për ribalancim të buxhetit, në të cilin do të sigurohen mjete më të mëdha financiare në fushën e kulturës.

Komuna e Radovishit, nën patronazhin e shtëpisë së kulturës „Aco Karamanov“, realizon disa programe në fushën e kulturës, siç janë shfaqjet e baletit modern „Gazelat“, projekttime filmash për fëmijë, evropian, serb, maqedonas, stand ap shou, kinematë verore, punëtoritë e artit figurativ dhe shfaqjet teatrore. Nga e lartpërmendura mund të arrihet në përfundim se e tërë veprimtaria kulturore zhvillohet në shtëpinë e kulturës „Aco Karamanov“.

Me fjalë të tjera, në Radovish nuk ka ekzistuar projektimi kinematografik prej vitit 1997 deri në vitin 2018. Falë angazhimit të punonjësve në shtëpinë e kulturës „Aco Karamanov“, në v. 2018 kur si drejtoreshë u emërua Izabella Angellova, në shtëpinë e kulturës filloi projeksioni i filmave “nëpër derën e vogël”. Pra, atëbotë drejtoresha aktuale mbasi pa se në atë godinë nuk ekziston madje një pëlhurë e vetme në të cilin filmat do të mund të projektoheshin, e njëjta me vetiniciativë përpunoi pëlhurën e cila përdoret edhe sot. Në këtë çast projektohen filma të animuar, maqedonas, serb, evropianë, por jo edhe filma për të cilët është e nevojshme të përmbushen kushtet plotësuese të cilat i kërkojnë distributorët e filmit gjatë lidhjes së marrëveshjes me të njëjtit, ndërsa një nga to është pajisja DCP Player (pakoja e kinemasë digjitale). Krahas të dhënave të lartpërmendura, shtëpia e kulturës ka teknologji të vjetërsuar, respektivisht ekziston mungesë e zërimit të posaçëm. Në vitin e kaluar, respektivisht në vitin 2022, gjatë muajve të ndryshëm, janë projektuar filma më së shpeshti dy deri tri herë brenda muajit përkatës, por ndonjëherë edhe një herë në muaj.

Atë që mund ta vërejmë nga anketa e realizuar në formë elektronike e pyetësorit të anketës është se prej gjithsej 102 të anketuarve, 20% u përgjigjën se asnjëherë nuk e vizitojnë shtëpinë e kulturës, 35% e vizitojnë shumë rrallë, ndërsa 31% e vizitojnë ndonjëherë. Si plotësim, 50% e të anketuarve u përgjigjën se momentalisht nuk projektohen numër i mjaftueshëm filmash dhe se të njëjtit nuk kanë llojllojshmëri të mjaftueshme. Burimi i problemeve të lartpërmendura është i natyrës financiare, respektivisht investimi i pamjaftueshëm në shtëpinë e kulturës dhe përshtatja e të njëjtit me pajisjet e nevojshme dhe ndarja e një pjese të vogël mjetesh për këto qëllime.

Siç mund të vërejmë nga Buxheti i Komunës së Radovishit për v. 2023, për Kulturë janë caktuar gjithsej 11.521.343 denarë, dhe kryesisht këto mjete destinohen për 4 programe, e ato janë: bibliotekari, veprimtari muzikore dhe skenike-artistike, manifestime kulturore dhe krijimtari, si dhe për shpenzime kapitale në Komunë, për të cilat janë paraparë më së paku mjete, respektivisht vetëm 65.000 denarë nga shuma e përgjithshme, që do të duhej të caktoheshin për furnizim me pajisje të nevojshme. Sa për krahasim, një manifestim që

mbahet në Komunën e Radovishit është “Samun em Tatlia”, për organizimin e të cilit nevojiten 9.000.000 denarë.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Si pjesë e masave që do të përfaqësojnë zgjidhje për këtë problem së pari është rikonstruksioni i sallës së kinemasë ose ndërtimi i objektit të veçantë me destinim të caktuar për projektim filmash - kinema, ndryshe nga qendra kulturore shumëfunksionale aktuale. Zgjidhja e këtillë do të nënkuptonte pajisjen e plotë të objektit, me destinim të caktuar – projektim kinemaje. Por, për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare të zgjidhjes së këtillë, duhet të punohet në vazhdimësi dhe në periudhë afatgjate. Si plotësim, propozohen masa të tjera në formën e zgjidhjes së përkohshme dhe këtë janë: furnizimi i DCP Player-it – një pajisje teknologjike që shërben për siguri dhe mundëson lidhjen me distributorët e filmit, ndërsa furnizimi i saj është një nga kushtet themelore gjatë lidhjes së marrëveshjes me distributorët; furnizim i sistemit special të zërimit; punësime të reja, respektivisht plotësimin e nevojave të burimeve njerëzore dhe atë për personat që do të shesin bileta, personat që do të menaxhojnë zërimin dhe ngjashëm.

Një lloj vërtetimi për pohimet e këtilla janë edhe rezultatet e anketës së lartpërmendur në të cilën 62% e të anketuarve konsiderojnë se është optimale që të projektohen filma një herë në javë, përderisa 99% e të njëjtëve konsiderojnë se qytetarët e komunës së Radovishit do të përfitojnë shprehë për të vizituar shtëpinë e kulturës nëse ka projektim më të mirë dhe më të shpeshtë të filmave.

Në takim me koordinatoren e grupit këshillëdhënës Simona Cvetanovski, e më pas edhe në takim me këshilltarët e tjerë në takimin e tyre koordinues, këshilltarët shprehën qëndrim pozitiv ndaj kësaj iniciative dhe zhvillimit të së njëjtës, dhe rrjedhimisht implementimin e saj. Sipas kësaj, në bashkëpunim me këshilltarët e LSDM-së në Këshillin e Komunës së Radovishit, qëllimi ynë përfundimtar është që të parashtrojmë një kërkesë për rebalancin e Buxhetit, me të cilën do të kërkojmë të caktohen mjete më të mëdha financiare në pjesën e shpenzimeve kapitale të parapara për fushën e kulturës, me çka do të furnizohet teknologjia e nevojshme, duke pasur për qëllim projektimin e suksesshëm të numrit më të madh e më të larmishëm të filmave, pas lidhjes së marrëveshjes me distributorët.

Angazhimet e komunitetit në Qytetin e Shkupit

1. Mungesa e vendparkimeve në Qytetin e Shkupit - Marija Milloshevska (VMRO-DPMNE)





**MUNGESA E
VENDPARKIMEVE NË
QYTETIN E SHKUPIT**

**„Недостиг на паркинг
места во Скопје“**

**Mungesë e parkingjeve
në Shkup**

**Marija Milloshevska
- VMRO-DPMNE -**



Përmbledhja

Dokumenti i Marijës për politika publike trajton problemin e mungesës së vendeve për parkim në Shkup. Për këtë sfidë ajo bëri një anketë me më shumë se 800 qytetarë nga të gjitha komunat e Qytetit të Shkupit, prej të cilëve, afër 80% konfirmuan nevojën për më shumë parkingje, pothuajse në çdo vendbanim të kryeqytetit. Marija u takua edhe me këshilltarët e VMRO-DPMNE-së në Qytetin e Shkupit, të cilët prematuan se së bashku dhe në koordinim me autoritetet e qytetit do të punojnë për fillimin e procesit për ndërtimin e garazheve të parafabrikuara apo shumëkatëshe në lagjet e Shkupit.

Një nga problemet më të mëdha me të cilat momentalisht përbaëen qytetarët e qytetit të Shkupit është mbipopullimi. Me kalimin e viteve, qyteti i Shkupit është shndërruar në një qytet milionësh, veçanërisht në kohët e javës së punës nga e hëna në të premte. Këtë e vërtetojnë shifrat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2021, por dhe situata faktike me të cilën banorët e qytetit përballen në përditshmëri. Sipas regjistrimit, në kryeqytet jetojnë 526.502 banorë dhe janë regjistruar 171.171 amvisëri dhe 213.850 banesa.

Si pasojë e kësaj, po shtohen ritmet e rritjes së popullsisë së Shkupit dhe rrjedhimisht vjen gjithnjë duke u shtuar edhe numri i automjeteve në kryeqytet, kurse mungesa e hapësirave të mjaftueshme për parkimin e automjeteve paraqet sfida për banorët e tij.

Mungesa e vendparkimeve paraqitet nga disa arsye, shtimi i sipërpërmendur i banorëve, koncentrimi i tyre në objektet banesore për të cilat s' kanë siguruar garazh -vendparkim personal , ata njerëz të cilët vendin e punës e kanë në zonën qendrore të qytetit dhe udhëtojnë çdo ditë me transport personal për në punë, si dhe ata qytetarë të cilët përditë lëvizin pranë spitaleve, bankave, objekteve të hotelerisë si dhe në veprimtari të tjera shërbyese në Shkup.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Për gjetjen e zgjidhjes adekuate, hulumtuam në mënyrë më të detajuar mundësinë e vendosjes së parkingjeve të reja të montuara apo garazheve shumëkatëshe jashtë zonës qendrore të qytetit, të cilat do ta shkarkojnë rrëmujën e qytetit dhe do ta mundësojnë qasjen në objektet tregtare.

U zbatua një anketë në të cilën morën pjesë 805 të anketuar. Rezultatet e anketës janë si vijon: 78% konsiderojnë se ndërtimi i garazheve të reja shumëkatëshe ose të montuara jashtë zonës qendrore të qytetit, do ta zgjidhte problemin e pmjaftueshmërisë së vendparkimeve në qytetin e Shkupit. Në pyetjen, cila komunë konsiderojnë se ka nevojë për këtë tip parkingu, 33.7% u përgjigjën Aerodromi, 32% Kisella Voda, 30.8% Çairi, 1.4% Karposhi, 0,7 Gazi Baba 0,6% Buteli, и 0,4 Gjorçe Petrovi. Ndërsa 83.4% e të gjithë të anketuarve, u shprehën se po të ekzistonin këto garazhe do t'i kishin përdorur.

Gjithashtu u realizua një takim me përfaqësuesit e Grupit Këshillëdhënës të VMRO-DPMNE-së dhe të koalicionit, ku atyre iu bë e ditur se qytetarët presin zgjidhje të problemit nga autoritetet e qytetit dhe u shpalosën rezultatet e

anketës së realizuar. Ata e mbështetën mendimin e qytetarëve dhe në bashkërendim me autoritetet komunale do të punojnë në drejtim të nisjes së procesit për ndërtimin e garazheve të montuara ose shumëkatëshe në lagjet e Shkupit.

Në seancën e fundit të Këshillit të Qytetit të Shkupit, në janar të vitit 2023, u parashtrua Plani zhvillimor për mirëmbajtjen, realizimin dhe menaxhimin e parkingjeve publike në zonën e qytetit të Shkupit për periudhën 2023-2025. Lënda e këtij plani zhvillimor është ndërmarrja e aktiviteteve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen, realizimin dhe menaxhimin e parkingjeve publike në zonën e Qytetit të Shkupit, si dhe rritjen e kapacitetit të komunikacionit stacionar në parkingjet publike dhe hapësirat publike për parkim, me të cilin menaxhon NP Parkingu i qytetit - Shkup. Ndër të tjera, në këtë plan zhvillimor është parashikuar se NP Parkingu i qytetit - Shkup ka plan të instalojë garazhe shumëkatëshe në disa lokalitete të qytetit, përkatësisht në Çair, në Aerodrom dhe në Kisella Vodë.

Me instalimin e garazheve shumëkatëshe montuese-çmontuese do të shtohet numri i vendeve të caktuara për parkim të një sipërfaqeje, gjë që redukton kohën e nevojshme për gjetjen e një vendparkimi të lirë dhe ndikon në uljen e nivelit të ndotjes dhe ruajtjen e mjedisit, do të ketë efekt plotësues me çka do t'i rikthejë këmbësorët në trotuar, me këtë do të zmadhohet siguria e tyre dhe e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, do të lehtësohet qarkullimi i automjeteve si dhe do të përmirësohet kultura e trafikut.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Strumicës

1. Rivendosja e linjave të transportit publik në Strumicë - Andon Stojkov (LSDM)



RIVENDOSJA E LINJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK NË STRUMICË



**“Воспоставување на јавен превоз
во Струмица”**

**“Vendosja e transportit publik
në Strumicë”**

**Andon Stojkov
- LSDM -**



Përmbledhja

Komuna e Strumicës nuk ka transport publik që nga viti 1972, kur ky shërbim u ndërpre për shkak të paqëndrueshmërisë. Iniciativa e Andon-it synon ta kthejë këtë shërbim për qytetarët e Strumicës, duke rritur ndërgjegjësimin e institucioneve dhe zyrtarëve përgjegjës. Ideja u pasua nga një hulumtim i thelluar, i cili konsistoi në një anketë me mbi 140 të anketuar dhe takime me zyrtarë të ndryshëm komunalë, përfshirë edhe kryetarin e komunës. Të gjithë të anketuarit u pajtuan se Strumica ka nevojë për transport publik që do të funksionojë jo vetëm në zonën e qytetit, por do të mbulojë edhe fshatrat përreth. Kryesia komunale premtoi se për këtë qëllim do të formohet një grup punues i cili do t'i shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme dhe do t'i prezantojë ato më të përshtatshmet për komunën e Strumicës.

Komunën e Strumicës e përbëjnë qyteti dhe 25 vendbanime me një popullsi prej 54.676 banorë, nga të cilët 35.311 jetojnë në qytet sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2021. Në Strumicë janë regjistruar 12.519 automjete pasagjerësh dhe të tjera, të prodhuara brenda 15 vjetëve, që janë në përdorim në komunikacionin rrugor. Në transportin e pasagjerëve janë përfshirë edhe 67 firma të regjistruara që janë pajisur me licenca për kryerje transport auto-taksi, gjithsej 200 automjete.

Komuna e Strumicës nuk ka transport publik që nga viti 1972, kur ky shërbim u ndërpre për shkak të paqëndrueshmërisë. Në këtë çast, nevojat për transportin publik në Strumicë janë reale, me qëllim të shkarkimit të rrëmujës së komunikacionit në zonën qendrore të qytetit dhe mundësisë së qarkullimit të lehtë e sa më të përshtatshëm të kategorive të cenuara, siç janë: personat me status socio-ekonomik më të ulët d.m.th. ata persona që nuk kanë automjet personal, të moshuarit, gratë që nuk kanë automjet, personat me aftësi të kufizuara etj.

Gjatë anketës së zbatuar me mbi 140 të anketuar, në pyetjen: A ka nevojë Komuna e Strumicës për transport publik?, të gjithë të anketuarit, përkatësisht 100% u përgjigjën pozitivisht. Gjithashtu, në pyetjen: Ku nevojitet të realizohet transporti publik?, respektivisht, a duhet të përfshijë vetëm qytetin (zonën qendrore të qytetit dhe periferinë) ose edhe fshatrat përreth, të gjithë të anketuarit, respektivisht 100% u përgjigjën se duhet të realizohet në qytet dhe në fshatrat përreth. Krahas asaj se përfitim nga transporti publik do të kenë qytetarët që jetojnë në Strumicë, duhet cekur se transporti publik do t'u shërbejë edhe qytetarëve të fshatrave përreth, që bëjnë pjesë në Komunën së Strumicës. Ndër vendbanimet më të mëdha në rrethin e Strumicës, më i prekur nga ky problem është fshati Bansko.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje madhore, që shtron problem për qytetarët, si dhe për ruajtjen e ajrit të pastër (mjedisit jetësor), pas një bisede të zhvilluar me kryetarin e Komunës së Strumicës, Kostadin Kostadinov, dhe anketës së zbatuar me qytetarë, nevojitet rivendosja e transportit publik në Strumicë.

Hapat e zbatimit në të mirë të zgjidhjes së problemit konkret do të rrjedhin në 5 faza që do të zhvillohen në të njëjtën kohë, përkatësisht në mënyrë paralele.

Në përmbledhje janë dhënë këto pika:

1. Furnizimi i autobusëve
 - Nga biseda me persona profesionistë, duhen 12.000.000 denarë për furnizimin e dhjetëra autobusëve elektrikë.
2. Caktimi i linjave dhe stacioneve të autobusëve (nënstacioneve)
 - Incizimi i rrugëve për të përcaktuar linjat dhe nënstacionet.
3. Vendosja e pikave për mbushjen e autobusëve.
 - e shpejtë (gjatë ditës – gjatë kohës së pauzës)
 - e ngadaltë (gjatë natës kur autobusët nuk do të lëvizin).
4. Caktimi i çmimit
 - Përcaktimi i çmimit fillestar (çmimi për një udhëtim, biletë vjetore dhe biletë falas për nxënës, studentë dhe pensionistë.)
5. Punësimi i drejtuesve dhe kontrollorëve.

Qytetarët konsiderojnë se çmimi i një bilete nuk duhet të kushtojë jo më shumë se 20 denarë, ndërsa duhet të ekzistojë edhe mundësia e biletës mujore me përfitime. 68% e të anketuarve konsiderojnë se gjithashtu duhet të ekzistojë dhe mundësia e blerjes së biletës në autobus.

Në bisedë me kryetarin e komunës, nëpunësit komunalë dhe këshilltarët, u theksua se në të ardhmen e afërt komuna do të nisë procesin e rivendosjes së transportit publik në Strumicë dhe të gjitha analizat e sipërme dhe rezultatet e anketave do të merren parasysh komuna. Gjithashtu, do të formohet grupi punues ku do të kontribuojmë me propozime konstruktive edhe zgjidhje të mundshme të problemit në fjalë.

Angazhimet e komunitetit në Komunën e Çairit

1. Mungesa e parkingjeve në Komunën e Çairit - Esra Demiri (BDI)



MUNGESA E PARKINGJEVE NË KOMUNËN E ÇAIRIT



**„Зголемување на бројот
на паркинг места во Општина Чаир“**

**“Rritja e numrit
të parkingjeve në Komunën e Çairit”**

**Esra Demiri
- BDI -**



Përmbledhja

Vitet e fundit në komunën e Çairit mbizotëron një kaos në trafikun urban, si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të parkingjeve. Një nga arsyet e kësaj situatë është numri i madh i ndërtesave të reja (pallateve) në komunë, të cilat ndërtohen pa siguruar numër të mjaftueshëm parkingjesh për banorët. Për këtë qëllim, Esra ka kryer një anketë me 211 qytetarë, nga të cilët 48.3% mendojnë se ndërtimi i garazheve shumëkatëshe është zgjidhja më e mirë për këtë problem. Në kuadër të angazhimit të saj me komunitetin, ajo u takua edhe me këshilltarët bashkiakë, të cilët premtuan ta ngrenë këtë çështje në këshillin komunal.

Komuna e Çairit është komuna e vetme më e dendur në Evropë për nga numri i popullsisë, ndërsa shumë e vogël për nga sipërfaqja gjeografike. Dendësia e popullsisë në Komunën e Çairit është 16 193 banorë/km². Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 numri i banorëve arrin 62 586 gjithsej, me 31 032 të gjinisë mashkullore dhe 31 554 femërore. Përveç banorëve të regjistruar komuna ka edhe mbi 6 389 banorë jo rezident.

Si rezultat i kësaj, viteve të fundit po mbretëron edhe një kaos urbanistik në komunikacion. Një nga arsyet kryesore për këtë është edhe mungesa e parkingjeve publike. Qytetarët ankohen se nuk kanë ku t'i parkojnë automjetet e tyre, ndërkohë që autoritetet gjejnë arsye për mungesën e tyre. Banorët e kësaj komune konfirmojnë se hapsirat për parkim nuk janë aspak të mjaftueshme dhe kjo shkakton vonesë, mosmarrëveshje mes qytetarëve, aksidente trafiku, etj. Gjithashtu, mungesa e hapsirës për parkim rezulton me parkimin e veturave nëpër trotuaret. Okupimi i trotuareve rezulton me vështërsi edhe për lëvizjen dhe qasjen e personave me aftësi të kufizuara të cilët përdorin karroca, prindërit me fëmijë, biçiklista dhe këmbësorë në përgjithsi.

Ndërtimet pa leje, dhënia e lejeve për ndërtim të banesave të cilat nuk mundësojnë vend parkim dhe mungesa e zonave të parkingut kanë kontribuar në thellimin e këtij problemi. Kjo njëherit është vërtetuar edhe nga banorët nëpërmjet një ankete të realizuar për nevojat e këtij projekti, ku kanë marrë pjesë më shumë se 200 banorë të kësaj komune.

99% e të anketuarëve janë përgjigjur që mungesa e parkingjeve është problem shumë i madhë për banorët që jetojnë në komunën e Çairit. Nga të anketuarit, 83.7% janë përgjigjur se këtë problem e kanë paraqitur disa herë te organet kompetente, mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë masë nga ana e institucioneve relevante. Ndërkaq 16.3% e të anketuarëve nuk e kanë paraqitur këtë problem te instiucionet relevante, për shkak se janë të mendimit se edhe nëse do ankohen nuk do të mund të kenë përgjigje nga Komuna ose nuk do të ketë ndonjë efekt pozitiv apo ndryshim që mundet të bëhet, siç nuk është ndërmarr ndër vite.

Komuna nuk ka përmbushur premtimet e veta plotësisht sa i përket zgjidhjes së këtij problemi, përpos se në disa lagje ka pasur zgjerim të zonave aktuale që kanë qenë për parkim si dhe ndërtimin e parkingut mbi tregun e gjelbër. Banorëve u ishte premtuar seqë para një viti duhej të fillojë ndërtimi i 5 parkingjeve në kate, por ende nuk kanë filluar punimet për asnjë prej tyre. Nga Komuna e Çairit thonë se investimi nuk po realizohet për shkak se në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk kanë ardhur në rend të ditës ndryshimet

në Ligjin për investime të huaja. Ndërsa në ndërkohë komuna informoi se ka filluar procedurën për ndryshimin e Planit detal urbanistik (PDU), gjegjësisht përcaktimin e tre pikave për garazhe në kate.

Çfarë ndryshimi nevojitet?



Gjatë realizimit të anketës, u dhanë disa opsione të mundshme se cka mund të bëjë komuna për zgjedhjen e këtij problem. 48.3% e qytetarëve mendojnë që si opcion më efektiv dhe efikas për të zgjidhur problemin në këtë komunë është ndërtimi i garazheve në kate. Si opcion i dytë më i votuar nga ana e qytetarëve është zgjerimi i zonave aktuale të parkingjeve me gjithsej 26.8%. Qytetarët mendojnë se edhe parkingjet nëntoksore mund të jenë si opcion për zgjedhjen e këtij kaosi, me 24.9%, mirëpo momentalisht është investim më i ndërlikuar.

Në përmbledhje, kuptojmë se më se e domosdoshme është të bëhet zgjidhja e këtij problemi në kohë më të shkurtë dhe duhet të vendoset si prioritet nga ana e institucioneve relevante. Ky konkluzion ishte i përbashkët gjithashtu edhe me disa këshilltarë nga rradhët e Bashkimit Demokratik për Integrim në Komunën e Çairit, të cilët u pajtuan plotësisht me përfundimet e këtij dokumenti dhe premtuan që këtë problematikë do ta vëndojnë në diskutim në rend dite në seancat në vazhdim.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**SUPPORT TO
ELECTORAL REFORMS**
ПОДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ
MBËSHITETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE